



**UDHËZUES PRAKTIK PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN
E BANESAVE TRADICIONALE
NË FSHATRAT E BREGDETIT TË HIMARËS**

**UDHËZUES PRAKTIK PËR MBROJTJEN
DHE RUAJTJEN E BANESAVE TRADICIONALE
NË FSHATRAT E BREGDETIT TË HIMARËS**







0. Parathënie	5
1. Hyrje	9
1.1 Qëllimi i udhëzuesit	10
1.2 Ndërhyrjet rehabilituese	11
2. Karakteristikat e fshatrave	17
2.1 Zhvillimi historik i vendbanimeve	18
2.2 Struktura e vendbanimeve dhe peizazhi	20
2.3 Hapësirat publike	23
3. Banesa	31
3.1 Oborret	37
3.2 Fasadat	43
3.3 Muret	55
3.4 Portat dhe dyert	63
3.5 Dritaret	73
3.6 Ballkonet dhe verandat	81
3.7 Çatitë	87
3.8 Hapësirat e brendshme	95
Fjalor shpjegues termash	100
Bibliografia	102
Mirënjohje	105



4. Shtojca
Shtojca A: Ligje dhe rregullore
Shtojca B: Terminologjia në ligj
Shtojca C: Qendrat historike
Shtojca D: Si të marrësh leje
Shtojca E: Kontakte të dobishme





Hans-Jürgen Cassens
Drejtore për Shqipërinë
Shoqata Gjermane për
Bashkëpunim Ndërkombëtar
(GIZ)

Shqipëria është një vend i pasur me trashëgimi natyrore dhe kulturore. Vija e gjatë bregdetare prej 400 km, vargmalet e shumta, lumenjtë dhe tokat e kultivuara ndërthuren me një bollëk trashëgimie kulturore, pjesë të së cilës datojnë që nga periudha ilire. Rajoni bregdetar jugor nuk bën përjashtim. Malet, deti Jon si pjesë e detit Mesdhe, peizazhi kulturor shumë i larmishëm, sitet arkeologjike dhe fshatra të hershme që konservojnë traditat, janë karakteristikë për këtë zonë, që përbëjnë një vlerë të çmuar për sot dhe për të ardhmen.

Fshatrat e Bregut, si ato të Bashkisë Himarë, janë unike në mënyrën sesi shkrihen me peizazhin përreth. Duke u zhvilluar gjatë qindra viteve në përshtatje me nevojat e tyre, ato janë shndërruar në ansamble shumë të vyera veçorish karakteristike tradicionale. Banesat janë ndërtuar kryesisht prej gurëve të gdhendur, nxjerrë prej truallit lokal. Ato kanë forma karakteristike të tilla, që kur terreni e ka lejuar, kanë bërë që mjedisi kryesor i banesës të ketë pamje nga deti. Çatitë e pjerrëta dhe të kuqërreme dallojnë mes gjelbërimit të oborreve dhe peizazhit përreth. Sheshet, të cilat tradicionalisht shtrihen përreth një rrapi ose një çezme, përbëjnë bërthamën e secilit fshat-sepse nga pikëpamja fizike ndodhen në qendër të tij, ndërsa nga ajo sociale, përfaqësojnë pikëtakimin për komunitetin. Kjo pasuri duhet të mirëmbahet, mbrohet dhe rijetësohet vazhdimisht.

Udhëzuesi praktik për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Banesave Tradicionale në Fshatrat Bregdetare të Himarës ka si qëllim jo vetëm të shpjegojë kontekstin dhe karakterin e këtyre vendbanimeve, por edhe të orientojë e të ofrojë këshilla për të gjithë ata që janë të interesuar në ruajtjen, zhvillimin dhe përtëritjen e strukturave të këtyre fshatrave.

Ai iu drejtohet jo vetëm banorëve, por edhe pronarëve apo qiramarrësve të ndërtesave, si edhe administratorëve, institucioneve, kompanive ndërtuese, specialistëve dhe mjeshtërve të ndërtimit. Në këtë udhëzues janë përshkruar aspekte historike, janë nxjerrë në pah problemet ekzistuese dhe janë dhënë rekomandime praktike për mënyrën sesi mund të kryhen riparime dhe rikonstruksione të elementeve të reja me teknika të ndjeshme ndaj kontekstit. Shpresojmë se si i tillë, ai do të shërbejë si referencë dhe drejtim për rehabilitimin e banesave dhe të fshatit.

Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, po bashkëpunon me Qeverinë Shqiptare në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Në kuadrin e programit të Zhvillimit të Integruar dhe të Qëndrueshëm të Rajonit Bregdetar Jugor, kjo nënkupton zhvillimin e qasjeve për një turizëm të qëndrueshëm, mbështetjen e prodhimeve vendase si dhe të modeleve për mbrojtjen dhe rijetësimin e vendbanimeve tradicionale rurale.

Dëshiroj të shpreh mirënjohje e vlerësim të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në procesin e hartimit të udhëzuesit!

Kam kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës, të përgëzoj punën e lavdërueshme të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, për përgatitjen e Udhëzuesit për 14 fshatra të rajonit të bregdetit të jugut.

Duke ndjekur që në hapat e parë projektin e zbatuar nga Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), vlerësoj se është një projekt i suksesshëm dhe i dobishëm, i cili përfshiu një sërë institucionesh dhe trajton një tërësi fushash me një qëllim të përbashkët: mbështetjen e popullsisë rurale të rajonit të bregdetit të jugut për të përfituar nga zhvillimi ekonomik që sjell turizmi rural, kulturor dhe natyror. Rajoni i bregdetit të jugut është tejet i pasur me trashëgimi kulturore. Ruajtja e kësaj trashëgimie dhe promovimi i mënyrave dhe teknikave tradicionale të ndërtimit janë ndër drejtimet kryesore të punës së Institutit të Monumenteve të Kulturës. Nga kjo perspektivë e çmoj me shumë interes realizimin e këtij Udhëzuesi dhe besoj se ai do të jetë një mjet i dobishëm për rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve të këtyre fshatrave mbi vlerat e trashëgimisë kulturore dhe mënyrat tradicionale të ndërtimit të banesave në këtë rajon.

Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve në dy vitet e fundit (2015-2017) kanë dëshmuar përkushtim maksimal për evidentimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore në disa prej fshatrave të përfshirë në programin Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor. Shpallja e qendrave historike në Dhërmi, Vuno, Himarë fshat dhe Qeparo janë nismë e mbarë për vlerësimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në të gjithë rajonin.

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ekspertët që janë angazhuar për hartimin e këtij Udhëzuesi, Shoqatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për nismën, ekspertizën dhe mbështetjen financiare të këtij programi. Uroj dhe shpresoj për bashkëpunime të tjera në të ardhmen, për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Shqipëri.



Arta Dollani

Drejtore
Institutit i Monumenteve të
Kulturës (IMK)
Shqipëri



Jorgo Goro
Kryetar
Bashkia Himarë

Të nderuar banorë të Himarës,

Është krenari të pohojmë se ndër shekuj kemi trashëguar vlera të papërsëritshme të kulturës sonë unike, ku ndër të tjera, një vend të veçantë zënë banesat tona tradicionale. Ato janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Historikisht, nga koha në kohë, banori i Himarës, e ka mbështetur zhvillimin e vet mbi një trinom të pandarë të familjes së bashkuar, bashkëjetesës në komunitet dhe karakterit unik të shtëpisë së tij. Të pasuruara ndër vite, shtëpitë tona tipike për bregdetin, kanë krijuar gjithherë një tërheqje të pa rezistueshme për vizitorët e huaj, duke qenë gjithashtu edhe një pikë referimi për kthimin e bashkëqytetarëve tanë, të larguar nga vendi për arsye të ndryshme.

Himara ka kaluar shumë periudha të vështira, të cilat kanë lënë gjurmë që dëshmojnë për dëmtime të pakthyeshme në trashëgiminë tonë të ndërtimit tradicional. Një pjesë është dëmtuar për shkak të mungesës së kujdesit të shtetit të gjendur në kufijtë e ekzistencës së tij dhe një pjesë tjetër për shkak të mungesës së njohurive ose të papërgjegjshmërisë së institucioneve.

Megjithatë kohët kanë ndryshuar dhe këtë herë për mirë. Aktualisht, në kuadrin e ndërhyrjeve për përmirësimin urban dhe sidomos për peizazhin monumental urban, fokusi është në fshatrat e bregut të Himarës sonë. Reforma e re territoriale solli që ato të përfaqësohen të bashkuar ashtu si edhe i ka njohur historia.

Sot janë hapur një sërë kantieresh ndërtimi. Me ritëm të shpejtë dhe në garë me kohën, po bëhet një punë e mirë për të rritur cilësinë e mënyrës së jetesës, për të pasur sa më shumë lloje shërbimesh turistike dhe për të arritur një përfaqësim unik të Rivierës tonë në arenën botërore.

Por, e gjithë kjo përpjekje nuk duhet të jetë e njëanshme, por përkushtim i të gjithëve bashkë, për të mirën e përbashkët. Ne të gjithë duhet të kontribuojmë në restaurimin dhe ripërtëritjen e banesave tona, rrugicave tradicionale, oborreve dhe të gjitha elementeve, që si pjesë të një mozaiku krijojnë imazhin tonë unik.

Ky Udhëzues është krijuar posaçërisht t'iu ndihmojë në përpjekjet tuaja për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e banesave. Janë këto shtëpi, që kërkojnë nga ne t'i ruajmë për t'ua lënë trashëgim pasardhësve tanë, siç ata do t'i dëshironin.

Shpreh një falënderim të veçantë për Shoqatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) - Shqipëri, të mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, për Ministrinë tonë të Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, specialistët e trashëgimisë kulturore dhe në veçanti për banorët e fshatrave të Himarës, që gjatë një sërë seminaresh e takimesh ia dolën të kontribuonin e t'i jepnin udhë këtij Udhëzuesi, të pasur me njohuri dhe informacion, të vlefshëm për sot dhe për të nesërmen!



1. Hyrje



a. Harta e 14 fshatrave të bregdetit të Himarës, të përfshira në studim.

b. Pjesëtarë të ekipit, duke biseduar me banorët e fshatrave, gjatë punës në terren.

c. Foto nga një prej takimeve me kryetarët e 14 fshatrave, përfaqësues të Bashkisë Himarë, profesionistë dhe përfaqësues të kompanive të ndërtimit, që punojnë në këtë rajon.

d. Takimi i parë i mbajtur në Tiranë në të cilin morën pjesë profesionistë të arkitekturës dhe restaurimit, përfaqësues të institucioneve të trashëgimisë kulturore, etj.

Ky Udhëzues është përgatitur në kuadrin e programit *Zhvillimi i Integrues dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor*, i zbatuar nga Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) - Shqipëri, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Zona në fokus e këtij udhëzuesi përfshin katërmëdhjetë fshatra të rajonit bregdetar të Himarës, përkatësisht: Palasë, Dhërmë, Ilias, Vuno, Himarë fshat, Pilur, Kudhës, Qeparo i vjetër, Borsh, Piqeras, Sasaj, Lukovë, Shën Vasil dhe Nivicë.

Grupi i punës që hartoi këtë udhëzues praktik përbëhet nga ekspertë vendas dhe të huaj.

Një ndër synimet kryesore gjatë procesit të realizimit të këtij udhëzuesi ishte përfshirja e aktorëve të ndryshëm: banorë vendas, ekspertë dhe institucione të trashëgimisë kulturore, Bashkia, si dhe organizata vendore e ndërkombëtare, që kontribuojnë për trashëgiminë kulturore në Shqipëri. Grupi i punës kreu hulumtime në terren, analiza të gjendjes ekzistuese të fshatrave historike, zhvilloi intervista, pyetësorë dhe diskutime me banorët dhe aktorë të tjerë me ekspertizë në këtë fushë, në secilin prej fshatrave të përfshirë në projekt. U bënë kërkime në studime të mëparshme për ndërtimet tradicionale në këtë zonë, në arkiva dhe biblioteka të institucioneve që trajtojnë trashëgiminë kulturore.

Gjatë procesit të hartimit të udhëzuesit, ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm mes grupit të punës dhe institucioneve përkatëse. Janë zhvilluar një sërë forumesh dhe konsultash si me banorët vendas ashtu edhe me ekspertë të trashëgimisë kulturore.

Ky udhëzues shoqërohet edhe me një libërth më vete, që përmban informacion plotësues për ligjet dhe rregulloret në fuqi, procedurat e aplikimit për leje rikonstruksioni si edhe adresa të dobishme e kontakte të nevojshme.



1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Fshatrat e Jugut të Shqipërisë janë unike për sa i përket pozicionit që kanë kundrejt mjedisit natyror përreth. Ato janë zhvilluar gjatë qindra viteve duke iu përshtatur nevojave dhe rrethanave të popullsisë që kanë jetuar aty me shekuj. Prandaj është krejt e natyrshme prirja për të nxjerrë në pah elementet që i bëjnë këto fshatra të ndryshëm dhe krejt të veçantë.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është:

- të shpjegojë kontekstin dhe karakterin e këtyre fshatrave;
- të japë këshilla dhe të orientojë të gjithë ata që merren me zhvillimin, rinovimin ose rikonstruksionin e ndërtesave të fshatit, pavarësisht sa të mëdha ose të vogla mund të jenë ato;
- të përshkruajë rregullat, që duhen mbajtur parasysh në rinovimet e ndërtesave historike;
- të orientojë për restaurimin e kujdesshëm dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe pjesëve të ndryshme të tyre;
- të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e këtyre vendeve, për vlerat e tyre si pasuri kombëtare dhe karakterin origjinal lokal që i dallon.


Ky udhëzues është i vlefshëm si për banorët, pronarët apo qiramarrësit e ndërtesave, edhe për institucionet, administratorët, kompanitë ndërtuese, mjeshtër të ndërtimit dhe artizanët. Udhëzuesi identifikon ato elemente tipike të fshatrave dhe ndërtesave, të cilat kanë formuar karakterin e tyre lokal, me qëllim që të sigurojë që çdo ndërtim i ri të jetë në përputhje me këtë karakter. Në këtë udhëzues janë përshkruar aspekte historike, janë nxjerrë në pah problemet ekzistuese dhe janë formuluar udhëzime praktike se si mund të bëhen riparime, restaurime ose ndërtime të reja, me ndjeshmëri ndaj kontekstit.

Udhëzuesi është mbështetur në ligjet, vendimet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si: Ligji “Për trashëgiminë kulturore”, nr. 9048, datë 07.04.2003; Vendimet e Këshillit të Ministrave për shpalljen e qendrave historike të fshatit Himarë fshat (nr. 28, dt. 20.01.2016), fshatit Dhërmi (nr. 29, dt. 20.01.2016), fshatit Vuno (nr. 30, dt. 20.01.2016) fshatit Qeparo (nr. 636, dt. 07.09.2016), dhe vendimin për miratimin e Rregullores për administrimin e tyre dhe të zonës së mbrojtur përreth.




a. Pamje e fshatit Dhërmi, e parë nga një rrugicë e lagjes Gjilekë.

b. Foto e bregdetit të Himarës, marrë nga Qafa e Llogarasë, ku dallon vendndodhja unike e fshatrave. Në pamje të parë fshati Palasë dhe Dhërmi.



b.

1.2 Ndërhyrjet rehabilituese



c. Një banesë e fshatit Dhërmi në restaurim. Gjatë procesit po shtohet një ballkon betoni në fasadën e përparme dhe janë vendosur dritare e dyer prej druri.

d. Portë në fshatin Ilias. Kjo banesë është restauruar nga programi “Çati dhe Fasada” i Bankës Botërore.

e. Pamje e çatisë së një banese në Dhërmi gjatë rindërtimit – pjesë e programit të FSHZH-së, që po zbatohet në fshatrat Vuno dhe Dhërmi.

Arkitektura tradicionale popullore zë një vend shumë të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore shqiptare. Në dhjetëvjeçarët e fundit janë bërë përpjekje të ndryshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e kësaj trashëgimie kulturore. Duke filluar nga vitet '70-të të shekullit të kaluar, institucionet shtetërore kanë dekretuar ligje të posaçme për mbrojtjen e tyre dhe kanë shpallur si *monumente të mbrojtura kulture* të gjitha objektet e konsideruara me vlera arkitektonike dhe historike. Mjedisi i këtyre nismave ka qenë përshkruar nga ideologjia politike e regjimit të mëparshëm, e cila karakterizohej nga elemente të theksuara ateiste dhe nacionaliste. Këto elemente, ndërsa çuan në shkatërrimin ose ndryshimin e funksionit të ndërtesave dhe simboleve fetare, lejuan mbijetesën e banesave tradicionale. Në këto kushte mjaft studiues të kohës patën mundësinë të identifikonin dhe studionin tipologjitë e banesave tradicionale shqiptare.

Në kushtet e reja, shumë pronarë të banesave tradicionale, vitet e fundit, kanë filluar t'i rinovojnë ato dhe t'i përshtatin për funksione të reja. Deri më sot, dy programe janë fokusuar në rijetësimin e banesave tradicionale. Një program i Bankës Botërore, (2013-2016) i zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban, i cili promovoi vlerat e arkitekturës tradicionale nëpërmjet një projekti të vogël pilot për rindërtimin e çatave dhe fasadave; 62 banesa të këtyre fshatrave u përfshinë në program.

Aktualisht, është në zhvillim një projekt rikualifikimi urban në fshatrat Dhërmi dhe Vuno. Ky projekt, i zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përfshin punë restauruese në rrugë, trotuare, sheshe dhe fasada të banesave tradicionale, ndriçim të mjediseve publike etj. Kjo veprimtari është një nismë e Qeverisë Shqiptare/Ministria e Kulturës, e cila ka siguruar një kredi nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës për të realizuar projekte të rikualifikimit urban në fshatrat Dhërmi e Vuno të Bashkisë Himarë.





Katërbëdhjetë fshatrat e bregdetit të Himarës



Hartë e fshatit Palasë dhe një foto e marrë nga kodra jugore, që tregon disa banesa të fshatit me pamje nga deti.



Palasë



Hartë e fshatit Dhërmi dhe një pamje e fshatit, parë nga pjesa lindore e tij. Fotoja vë në dukje morfologjinë e fshatit Dhërmi dhe marrëdhënien e tij me detin.



Dhërmi



Hartë e fshatit Ilias. Foto e fshatit e marrë nga rruga kombëtare, që ilustron shtrirjen e tij në peizazh.



Ilias



Hartë e fshatit Vuno dhe një foto e fshatit, marrë nga kodra jugore, ku duket rruga kombëtare që kalon mepër fshatit.



Vuno

Shënim: Hartat e fshatrave janë ilustruese dhe skematike. Ato kanë për qëllim të tregojnë strukturën urbane dhe zgjerimin e vendbanimit të vjetër në secilin prej fshatrave.



Katërmëdhjetë fshatrat e bregdetit të Himarës



Himarë Fshat



Pamje e fshatit Himarë, që tregon për karakterin mbrojtës të fshatit, vendosur në majën e një kodre, nga ku mbikëqyr detin dhe malet përreth. Harta e fshatit Himarë.



Pilur




Foto e fshatit Pilur, e marrë nga lartësiti e kodrave, që nxjerr në pah karakterin e shpërndarë të fshatit; dhe një hartë e Pilurit.



Kudhës




Foto nga fshati Kudhës, i shtrirë në kreshtë malore. Vështruar nga lugina përballë fshatit. Hartë e fshatit Kudhës.




Qeparo Fshat




Pamje nga fshati Qeparo në kodër, siç shihet nga rruga gjarpëruese që të çon në fshat; si dhe një hartë e Qeparoit.




Borsh




Ndërtesë në fshatin e vjetër të Borshit, e cila vite më parë shërbente si shkollë dhe një hartë e fshatit Borsh.



Hartë e fshatit Piqeras që shtrihet përgjatë një kreshte malore dhe një foto e fshatit, e marrë nga mali në lindje të tij.




Piqeras



Hartë e fshatit Sasaj dhe një pamje e fshatit, që dëshmon karakterin unik të tij, me banesa të shpërndara në terrenin kodrinor.




Sasaj



Hartë e Lukovës dhe foto e fshatit, që tregon vendndodhjen e tij në kreshtë malore, me pamje dhe shtrirje drejt bregdetit.




Lukovë



Hartë e fshatit Shën Vasil dhe një pamje e tij, e marrë nga kodrat më lart, që paraqet strukturën dhe përbërjen e fshatit. Gjatë socializmit, fshati u zhvillua me shpejtësi dhe u ndërtuan blloqe të reja banimi.



Shën Vasil



Harta e Nivicës dhe një foto e fshatit, e marrë nga pjesa jugore. Prej fshatit Nivicë mund të shihet peizazhi kodrinor me brezare dhe rruga kombëtare.



Nivicë



2. Karakteristikat e fshatrave



a. Pamje e fshatit Kudhës dhe peizazhit përreth.

b. Një rrugicë në Vuno, e cila paraqet sesi lidhen banesat mes tyre, nëpërmjet kalimeve të ngritura mbi harqe dhe nënkalimeve.

c. Skicë e fshatit Vuno, vështruar nga kodra juglindore e tij. Autor: Elton Hala, punuar gjatë "Sketching Cultural Heritage Workshop" të programit ISDSCR/GIZ.

Vendbanimet e bregdetit jonian konsiderohen të jenë ndër pasuritë më të rëndësishme etnografike dhe arkitektonike të rajonit jugor dhe jugperëndimor shqiptar. Këto vendbanime janë të vendosura në kodra e pllaja, në lartësi 300-600 metra dhe kanë pamje piktoreske drejt detit Jon. Fshatrat e këtij rajoni shtrihen në hapësirën ndërmjet Parkut Kombëtar të Llogarasë dhe qytetit të Sarandës në jug të vendit.

Ato përfaqësojnë një karakter të fortë mesdhetar, në sajë të arkitekturës tradicionale vernakulare, strukturës kompakte të fshatit, por edhe të materialeve të përdorura (gurë, dru dhe tjegulla), afërsisë me detin dhe marrëdhënies me peizazhin përreth. Terreni i këtij rajoni është i përbërë përgjithësisht prej pllajave dhe kodrinave të larta e luginave, të cilat të kombinuara me kushtet klimatike, favorizojnë më shumë mbarështimin e dhenve sesa rritjen e kulturave bujqësore. Karakteristikat tipike të peizazhit përfshijnë tarracat me ullishte dhe agrume në territoret përreth vendbanimeve, të cilat u hapën gjatë periudhës së socializmit. Këto janë veçori të pandara të peizazhit të fshatit dhe së bashku me strukturën që ai ka, përbëjnë peizazhin kulturor të tij.





2.1 Zhvillimi historik i vendbanimeve

Zona e Himarës, ose siç njihet ndryshe, Bregu, përmendet që në shek. V para Krishtit, nga historianë si Herodoti dhe Tuqididi. Gjithashtu, në disa dokumente të periudhës bizantine përmenden fshatrat e kësaj zone si Borshi, Qeparoi, Lukova, Çorraj etj. Kalaja e Sopotit në Borsh, Vunoi etj., vlerësohet të kenë qenë të banuara që në kohërat e lashta. Gjurmë të Epokës së Bronzit janë gjendur në Lukovë, Ilias dhe Qeparo, të cilët kanë qenë pjesë e qytetërimit të lashtë të Kaonisë, që daton prej shek. VI para Krishtit dhe përkon me Borshin e sotëm.

Bazuar në disa dokumente të shek. XV, kjo zonë ka qenë e pasur me vendbanime, edhe pse disa prej tyre janë zhdukur me kalimin e viteve. Regjistri zyrtar otoman i viteve 1431-1432 ka të dhëna për fshatrat Dukat, Palasë, Sopot dhe Dhërmi. Sipas regjistrit, popullsia e Dhërmiut të asaj kohe numëronte 1850 banorë dhe ajo e Himarës 1430 banorë. Gjithsesi, dëshmohet se këto vendbanime kanë qenë të banuara shumë më herët. Kjo zonë ka pasur gjithmonë lidhje të rëndësishme ekonomike në rajon, nëpërmjet shitjes së frutave të prodhuara në vend nga njësitet e vogla familjare. Produktet transportoheshin kryesisht nëpërmjet tokës, prandaj nuk ka pasur nevojë për porte, edhe pse kishte dy të tillë, në Himarë e Vuno.

Një karakteristikë tipike e shumë prej këtyre fshatrave është vendndodhja e tyre në terrene të larta me pamje të bukur nga deti. Ka disa arsye për këtë vendndodhje. Së pari, kjo lidhej me mundësinë e shfrytëzimit të ujit të freskët dhe të kulluar prej burimeve të terreneve malore. Së dyti, lidhej me disponueshmërinë e tokës së punueshme dhe së treti me mundësinë për t'u mbrojtur. Vendbanimet që ndodhen në terrene më të larta zotërojnë krejt peizazhin dhe sigurojnë mbrojtje natyrore.

Arsye të tjera lidhen me disavantazhet e tokave të ulëta, pranë detit, të cilat janë më të lagështa, gjë që kufizon mundësitë për të qenë të punueshme. Për shembull, fshati Pilur, siç dëshmojnë rrënojat, ka qenë fillimisht më pranë bregut të detit, në një lartësi më të ulët sesa vendbanimi i ditëve të sotme.



a. Pamje e Gjirit të Himarës e vitit 1940, ku banesat dhe ndërtesat e tjera janë të vendosura në kodër, ndërsa tokat pranë bregut përdoren si tokë bujqësore. Foto nga Giuseppe Massani, 1940.

b. Palasa (Palása/Palazza), pikturë nga Edward Lear, 1848.





c. Foto e fshatit Dhërmi, e cila paraqet strukturën e fshatit, relativisht të ngjashme me atë të sotmen. Rruga kombëtare është e shtruar me zhavorr. Në planin e parë duket një prift. Foto nga *Giuseppe Massani*, 1940.


d. Një foto e pjesëtarëve të grupit polifonik të Himarës. Në sfond fshati Dhërmi. Fotoja është bërë në fillimin e viteve '90-të, gjatë xhirimeve të dokumentarit "Në lundrën e këngës". Autori: Lefter Çipa.

Edhe pse vendbanimi i ri përballlet me një mot pak më të keq, veçanërisht në dimër, zhvendosja graduale në një lartësi më të madhe, ishte padyshim e ndikuar nga përparësitë e përshkruara më sipër.

Gjatë periudhës së socializmit (1946-1991), një ndër zhvillimet më të rëndësishme ishte kufizimi e më pas heqja e të drejtës së pronës private. Pas vitit 1976, edhe ligjërisht askush nuk zotëronte më pronë. E vetmja dëshmi e pronësisë individuale ishin titujt e pronësisë të lëshuar përpara Luftës së Dytë Botërore. Gjatë 45 viteve të regjimit socialist, familjet e atyre të cilët posedonin këta tituj pronësie u shtuan me breza. Si rezultat, pas rënies së sistemit socialist, një pronë u pretendua papritmas deri edhe nga 20 individë ose më shumë pjesëtarë apo trashëgimtarë të këtyre familjeve.

Kjo dukuri ka krijuar një situatë kaotike. Këtë e përkeqëson edhe më tej fakti se ka edhe mjaft individë, të cilët nuk kanë tituj pronësie për banesat e tyre. Në ditët e sotme, paqartësia mbi titujt e pronësisë dhe mangësitë e mekanizmave ligjorë për të zgjidhur konfliktet e lindura për pronësinë, shpesh janë shkak i mospërdorimit të shumë prej banesave në këto fshatra, i braktisjes dhe përkeqësimit të gjendjes së tyre. Një tjetër problematikë që është krijuar rishtas në këto zona është ajo lidhur me emigrimin. Aktualisht, shumë banesa janë bosh ose banohen përkohësisht, gjë e cila ndikon në përkeqësimin apo edhe kthimin e tyre në rrënoja me rrjedhën e viteve. Për sa i përket banorëve që jetojnë gjithë vitin në fshat, shumica prej tyre ose nuk ka bërë asnjë ndërhyrje në banesë ose ka bërë ndërhyrje të papërshtatshme.

Zhvillimi i shpejtë i turizmit të lidhur me detin dhe trysnia e përgjithshme ekonomike kanë pasur ndikimin e tyre edhe në këto fshatra. Banorët e fshatrave shpesh janë zhvendosur më pranë bregut, duke i braktisur banesat e tyre, si p.sh. në Qeparo, Himarë fshat, etj. Disa të tjerë me paratë e fituara nga puna jashtë vendit, i kanë rindërtuar shtëpitë e tyre ose i kanë transformuar tërësisht, me shumë pak vëmendje për karakterin origjinal tradicional të ndërtesave në zonë.



d.



2.2 Struktura e vendbanimeve dhe peizazhi

Fshatrat janë relativisht të vogla, me një sipërfaqe prej 30 hektarësh në Dhërmi, 14 hektarë në Vuno, në Qeparo shkon në 6 hektarë, ndërsa edhe më pak në Ilias, 5.5 hektarë. Peizazhi i këtij rajoni ka dy karakteristika dalluese: vendbanimet e ngjeshura dhe fushat pjellore bujqësore, përtej të cilave ndodhen pyjet natyrorë dhe burimet ujore.

Në përgjithësi, shumica e fshatrave në këtë rajon janë të tipit *nucleus*, të përbëra nga banesa të grupuara rreth qendrës së tyre. Megjithatë ka disa fshatra, të cilat shtrihen në mënyrë lineare dhe zhvillohen përgjatë rrugëve kryesore.

Në të dyja rastet, ndërtesat janë zakonisht pranë njëra-tjetrës dhe përshkohen mes tyre nga rrugicat që zakonisht ndjekin topografinë e terrenit. Densiteti i strukturave të fshatrave në mjaft raste është i tillë sa shpesh rrugicat janë pa krye dhe si nënkalime poshtë banesave. Vendbanimet në këtë peizazh janë zhvilluar në tri mënyra të ndryshme: përgjatë kreshtave kodrinore, në shpatet e maleve dhe në majë të kodrave.

Thurja ndërtimore e fshatrave ndryshon në varësi të terrenit. Vunoi, për shembull, është i vendosur në shpatin e një kodre dhe struktura e tij është kompakte, ndërsa Piluri qëndron mbi një pllajë dhe është më i shpërndarë. Disa fshatra janë zhvilluar në tarraca që ndjekin linjat e terrenit malor si në rastin e Vunoit dhe Dhërmiut, ndërsa disa të tjerë shtrihen përgjatë kreshtës së kodrës, si për shembull Kudhësi, Lukova dhe Piqerasi.

Për shkak të vlerave tepër të rëndësishme të fshatrave të Himarës, katër prej tyre (Himarë fshat, Dhërmi, Vuno dhe Qeparo) janë shpallur Qendra Historike në 2016. Përveç qendrës historike, zona e mbrojtur e tyre përfshin edhe peizazhin përreth këtyre ansambleve historike, duke marrë emërtimin peizazh kulturor, gjë e cila rrit vlerat e fshatrave, por edhe të gjithë rajonit të Himarës.



a. Foto e manastirit të Panaisë në Dhërmi, i vendosur në pjesën më të lartë të kodrës, nga ku shihet fshati dhe deti.

b. Pamje e një kalimi me qemer, që shtrihet poshtë strukturës së banesës në Himarë.

c. Foto e fshatit Dhërmi, që paraqet strukturën e dendur të fshatit me rrugë të ngushta dhe shtëpi pranë njëra-tjetrës, që shohin nga deti. Në qendër të fshatit dallon dukshëm njëra prej kishave të tij.





d. Pamje ajrore e fshatit Kudhës, i vendosur në kreshtë malore.

e. Pamje ajrore e fshatit Qeparo, i pozicionuar në majë të kodrës.

f. Pamje ajrore e fshatit Vuno, i shtrirë në shpatin e malit.




Banorët e fshatrave të rajonit bregdetar kanë lidhje farefisnore dhe janë pjesë e familjeve të mëdha në numër. Këto familje kanë ngritur ndërtesa fetare, si manastire apo kisha, të cilat në të shumtën e rasteve ndodhen në pozicione të dukshme dominuese. Disa herë ato janë ngritur në periferi ose jashtë zonës së banuar të fshatit.

Klima në rajonin e Himarës është tipike mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë si dhe dimër me reshje. Disa fshatra, si për shembull Piluri dhe Kudhësi, ndodhen më larg bregut të detit dhe më lart, kështu që vera në këto fshatra është më e freskët dhe dimri më i ftohtë, krahasuar me zona të tjera në rajon. Shira të shumta ushqejnë përrrenjtë dhe lumenjtë gjatë stinës së shiut, dukuri që u siguron fshatrave furnizime të bollshme me ujë dhe mundësi për ruajtjen e tij.

Kushtet klimatike mesdhetare favorizojnë kultivimin e ullinjve dhe të agrumeve, të cilat rriten në tarracat që rrethojnë fshatin. Këto zona të kultivuara janë pjesë e qenësishme e të gjithë strukturës së fshatit. Brezaret zakonisht shtrihen nën nivelin e zonës së banuar të fshatit. Kodrat e pyllëzuara apo malet aty pranë shërbejnë si rezervë për kullota dhe lëndë drusore. Tokat e ashpra që nuk janë kthyer në tarraca ofrojnë pak mundësi për mbjellje kulturash, por janë të pasura në kullota, gjë e cila favorizon mbarështimin e dhenve. Pllajat e larta janë të bollshme në kullota verore, ndërsa ato më poshtë në veri dhe jug të rajonit kanë kullota të mira gjatë dimrit. Rajoni siguron kështu ushqim për bagëtitë gjatë gjithë vitit.



2.2 Struktura e vendbanimeve dhe peizazhi



a. Harta e fshatit Kudhës, i vendosur në një kreshtë malore në jugperëndim të Himarës, 6km nga deti Jon dhe 335m mbi nivelin e detit. Vendbanimi në mal ofron mundësinë që banorët të merren me bujqësi, blegtori dhe prodhime tradicionale.

b. Harta e fshatit Qeparo, i vendosur në majë të kodrës. Qeparoi është një nga fshatrat historikisht më të hershëm të Himarës, i cili ngrihet 300m mbi nivelin e detit dhe i ngjan një kështjelle. Afërsia me detin dhe terreni kanë favorizuar një shumëllojshmëri aktivitetshe ekonomike në zonë.

c. Harta e Vunoit, një fshat pozicionuar në një shpat mali shumë të pjerrët, në formë gjysmë hëne që përshkohet mospërmas nga rruga kombëtare. Fshatit ngjitet deri në rreth 300m lartësi. Emri i fshatit Vuno, rrjedh nga fjala greke *vouno*, që do të thotë mal. Mjedisi i ndërtuar është shumë kompakt dhe paraqet tipologji interesante banesash dhe rrugësh.



2.3 Hapësirat publike



d. Sheshi i fshatit Nivice. Shtruar me gur gëlqeror nën hijen e rrapit, sheshi ka pamje nga kodrat dhe brezaret e shtrira më poshtë.

e. Sheshi i fshatit Kudhës, i rijetësuar në vitet e fundit. Në pamje shihet një ndërtesë në qendrën e fshatit, e njohur dikur si mapo (magazinë popullore), e cila është ndërtuar në vitin 1966. Ky objekt atëherë ka shërbyer si një dyqan i përgjithshëm; sot funksionon si bar/kafene.

Qendra e fshatit

Sheshi i fshatit është ndër elementet më të rëndësishme të vendbanimeve të Bregut. Tradicionalisht, sheshet marrin një formë organike me një rrap qindravjeçar në mes, një element tipik, i cili vazhdon të jetë i pranishëm në mjaft fshatra. Në sheshe gjenden shpesh edhe *kroi* apo *çezma*, të cilët janë elemente të rëndësishme të fshatit. Shpesh, një apo disa nga anët e sheshit shohin drejt peizazhit dhe detit më tej.

Në këto sheshe ndodhen ndërtesa veçanërisht të rëndësishme për fshatin, si shkolla, kisha ose qendra kulturore e dikurshme. Historikisht, objekte të sheshit kanë qenë vetëm kisha dhe shkolla. Qendrat kulturore janë objekte të ndërtuara ose të përshtatura gjatë periudhës socialiste. Elementë të tjerë që gjenden në sheshin e fshatit janë përmendoret ose lapidarët, të cilët gjithashtu janë të periudhës socialiste. Shpesh, në shesh ndodhet edhe e vetmja kafene e fshatit ose *bufeja*, siç quhej ndryshe dikur.

Shtrimi

Sheshet e fshatrave janë zakonisht të shtruar me kalldrëm lidhur me llaç gëlqereje. Shumë prej këtyre shesheve janë zakonisht vazhdim i rrugëve kryesore, prandaj janë të shtruara njësoj si ato. Gurët merreshin nga guroret (*madëme*) aty pranë ose nga shtrati apo brigjet e lumenjve të afërt. Gurët tradicionalë të përdorur për shtrim kanë ngjyrë gri, të bardhë, bezhë ose pak të kuqërremë, si në Nivice. Gurët e shtrimit janë zakonisht të papërpunuar, por në disa raste, si për shembull në Lukovë, janë përpunuar pak, duke i bërë sipërfaqet më të lëmuara.

Ndriçimi

Nuk ka ndonjë dëshmi për përdorimin e ndriçuesve tradicionalë në këto fshatra. Llamba e parë elektrike, fare e thjeshtë, vendosur në një shtyllë druri, është ndezur në vitin 1960 në fshatin Kudhës. Përgjithësisht, në





2.3 Hapësirat publike

fshatrat e sotme ka disa llamba të thjeshta të varura në tela. Por ka edhe pak fshatra ku nuk ka fare ndriçim në hapësirat publike.

Pemët

Pema kryesore zakonisht është rrap, që ndodhet në qendër të sheshit. Rrapi është një pemë shumë e lartë. Disa prej pemëve në qendër të fshatit janë monumente natyrore të mbrojtura, për shkak të vlerave të tyre historike. Këto pemë kanë qenë gjithashtu vendi, ku mblidheshin banorët e moshuar të fshatit për të biseduar mbi shqetësimet që kishte fshati apo çështje të tjera të kohës.

Çezmat dhe burimet

Çezmat me ujë të pijshëm përfaqësojnë struktura interesante në këtë zonë. Ato furnizohen nga burimet ujore përreth, përrenjtë, lumenjtë, liqenet, por edhe ujërat nëntokësore. Në disa raste, strukturat e këtyre çezmave janë të pasuruara me elemente arkitektonike. Shpesh, ato quhen *kroje* apo *krua*. Dëshmi të këtyre elementeve gjenden në Kudhës, Lukovë, Qeparo (fshati i vjetër) dhe Ilias.



a. Rrapi i Palasës, i cili vlerësohet të jetë mbi 300-vjeçar.

b. Rrapi në sheshin e fshatit Nivice. Nën hijen e tij banorët e fshatit ulen dhe bisedojnë së bashku.

c. Një takim publik në hapësirën publike pranë Kishës së Shën Spiridhonit, në Vuno.





d. Një çezmë me dekoracion në Kallarë, fshat i shtrirë më thellë në territor, pas maleve dhe përgjatë luginës së lumit Shushicë, degë e Vjosës.

e. Çezma nën rrapin e qendrës së Iliasit.

f. Një nga sheshet në fshatin Qeparo, në pjesën e përparme të shkollës së fshatit. Pema tradicionale ofron hije në hapësirën publike dhe shërben si një vend për t'u mbledhur dhe biseduar.





2.3 Hapësirat publike

Rrugët dhe rrugicat

Struktura e rrugëve dhe rrugicave të fshatrave në këtë zonë, nuk ndjek një sistem të caktuar. Zakonisht fshatrat kanë nga dy apo tri rrugë kryesore. Këto rrugë bashkojnë qendrën apo hapësirën kryesore publike të fshatit me pikën më të lartë të tij, me pamje nga peizazhi rrethues e në shumë raste dhe nga deti; dhe/ose çojnë në tokat e mbjella në nivelet më poshtë. Rrugët kryesore arrijnë deri në pesë metra gjerësi, që në ditët e sotme bëjnë të mundur kalimin edhe të automjeteve, si në Palasë, Ilias, Nivicë, Lukovë, Dhërmi etj. Rrugët dhe rrugicat janë të shtruara me kalldrëm, me kanale të hapura për kullimin e ujit në mes ose në anë të tyre. Në vitet e fundit, kalldrëmi është zëvendësuar me beton të stampuar si në rastin e Nivicës, Piqerasit dhe Dhërmiut ose me asfalt si në rastin e Palasës. Ndërkohë dihet se kalldrëmi i shtruar mbi zhavorr dhe rrëzë është mënyra më e përshtatshme për shtrim, sepse lejon drenazhimin e ujit.

Rrugët dytësore ose rrugicat janë më të vogla, me gjerësi 2-3.5 metra dhe kalojnë përgjatë mureve rrethuese të banesave. Vendasit i quajnë ndryshe *sokak*. Këto rrugë ndjekin konturet e terrenit. Në rastin e Himarës fshat dhe Vunoit, për shkak të strukturës së dendur të fshatit, disa rrugica, të cilat mund të shkojnë deri në 2 metra gjerësi kthehen në nënkalime apo kalime me qemer, poshtë banesave.

Një element shumë i rëndësishëm i rrugicës dhe i banesës është sofati, i krijuar zakonisht prej gurësh të mëdhenj, të vendosur rrëzë portës; ai është një mobilie urbane, si një kufi mes hapësirës publike dhe asaj private. Portat e oborreve hapen drejt e në rrugë dhe shpeshherë vendosen gurë më të mëdhenj në pjesën e poshtme të murit, në anët e portës, për të krijuar sofartet. Ato shërbejnë si vende ku banorët ulen dhe pushojnë apo bisedojnë me fqinjët. Një tjetër tipar i rrugicave të ngushta që gjarpërojnë në fshat është rrumbullakosja dhe prerja e qosheve të mureve, për të lehtësuar kalimin nëpër fshat të kafshëve me ngarkesë.



a. Rrugët e shtruara me beton të stampuar në Nivicë, të ndërtuara në mënyrë që të lejohet kalimi i automjeteve në fshat. Asfaltimi me beton nuk inkurajohet, sepse nuk lejon depërtimin e ujërave.

b. Sofat i portës së një banese në Nivicë.

c. Pamja e një rrugice me qemer, të shtruar me gurë, në Vuno. Mbi rrugicën ngrihet një ndërtesë banimi.





d. Një qoshe e prerë dhe e rrumbullakosur e murit të një banese në Qeparo.

e. Fener i vendosur në një mur oborri në Himarë. Këto lloj ndriçuesish imitojnë tipa të hershëm, ndonëse këta të fundit nuk janë tradicionalë për zonën. Përdorimi i llambave moderne, të thjeshta, është shumë më i përshtatshëm.

f. Pamje e një rrugice të shkallëzuar në Himarë. Bimët dalin nga muret e oborrit dhe krijojnë hije në rrugë.

Pemët dhe lulet

Përveç rrapit në qendër të fshatit, zakonisht në rrugë nuk ka pemë të tjera. Banorët mbjellin pemë, lule, perime apo hardhi në oborret e tyre dhe vendosin vazo me lule në hyrje të portave, ndërsa hardhitë shpesh dalin mbi muret rrethuese në rrugë, duke krijuar pjergullore mbi rrugë. Në Lukovë, mbillen lule të mëdha të llojit Brugmansia, të cilat dalin mbi muret rrethuese ose portat.

Ndriçimi

Tradicionalisht, fshatrat nuk kanë pasur ndriçim në rrugë. Me elektrifikimin e vendit në fundin e viteve '60-të, rrugët zakonisht ndriçoheshin nga llambat e vendosura pranë shtëpive. Në ditët e sotme, në disa fshatra si për shembull në Himarë fshat, janë vendosur ndriçues rruge. Në rastin e Himarës ato u shtuan gjatë projektit të rjetësimit të Kalasë së Vjetër. Mbajtësit e ndriçuesve janë prej metali të thjeshtë, 2-3 metra të lartë, të dizenuar për t'u dukur si të hershëm, por që nuk janë elemente tradicionale të këtyre fshatrave. Ndërsa në fshatra të tjera, rrugët janë ende të ndriçuara me llamba të vendosura në muret e banesave private ose sipër portave hyrëse të tyre.

Sistemi i drenazhimit të ujërave

Sistemi i mbledhjes dhe kullimit të ujërave është tipik për rajonin dhe për vendbanimet që ndodhen në zona kodrinore. Për shkak të pjerrësisë së rrugës, uji kullon drejt kanaleve të hapura në anë ose mes të rrugicës dhe degëzohet në kryqëzim rrugësh dhe derdhet larg pjesës së banuar të fshatit. Në shumë raste ai përdoret edhe për ujitje të fushave poshtë fshatit.

Tradicionalisht, këto fshatra nuk kanë pasur sisteme kolektive të ujërave të zeza. Secila shtëpi kishte gropë septike individuale dhe në shumicën e rasteve ky lloj sistemi përdoret edhe sot. Vitet e fundit, flitet për ndërtimin e një sistemi të përbashkët të menaxhimit të ujërave të zeza në disa fshatra. Shembull për këtë është projekti i Rikualifikimit Urban në fshatrat Dhërmi e Vuno (rrugë, trotuare, sheshe, fasada, ndriçim publik etj.).



e.



f.



2.3 Hapësirat publike

Shënime

Sfidat për mirëmbajtjen dhe rikonstruksimin e hapësirave publike në fshatra janë të shumta: duke filluar nga vështirësitë për të ruajtur identitetin e sheshit të fshatit, tek alternimi i funksionit kryesor dhe transformimi ose humbja e elementeve të rëndësishme në sheshe dhe rrugë. Për më tepër, meqenëse rrugët e fshatit shpesh janë shumë të ngushta që nuk lejojnë kalimin e makinave, qarkullimi në to përbën një sfidë të vërtetë, veçanërisht në rast urgjence. Vështirësitë në qarkullim dhe mungesa e tabelave të duhura rrugore mbeten çështje që kërkojnë zgjidhje. Gjithashtu, nevoja për pajisje të mobilimit urban si ndriçues, stola, kosha plehrash etj. dhe vendosja e tyre, përbëjnë një tjetër sfidë. Realisht, si rikonstrukcioni edhe mirëmbajtja e hapësirave publike nuk janë një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e komunitetit; por nga ana tjetër është domosdoshmëri që komuniteti të jetë i ndërgjegjshëm për disa çështje kyçe (shih më poshtë) dhe të gjithë si qytetarë të përgjegjshëm, të marrin pjesë aktivisht në çdo proces planifikimi, projektimi dhe rikonstrukcioni të hapësirave publike.

Banorët e fshatit duhet ta kërkojnë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht kur është fjala për projektet e rehabilitimit të fshatrave (në këtë kontekst, identifikimi i tipareve kryesore, elementeve unike dhe i detajeve të secilit fshat dhe të çdo sheshi, është thelbësor).

Në rikonstruksimin e rrugëve dhe shesheve duhet të përdoren materialet lokale si p.sh. guri gëlqeror në ngjyrë gri, të bardhë, bezhë apo ai i kuqërremë dhe jo betoni i stampuar apo asfalti, të cilët nuk lejojnë drenazhimin e ujit dhe për më tepër, ndikojnë negativisht duke dëmtuar identitetin tradicional të këtyre vendbanimeve. Elementet e reja që shtohen si mobilie urbane, ndriçuesit, stolat, koshat për plehrat etj., duhet të jenë në përshtatje me çdo kontekst historik, por mirëmbajtja si një e mirë e përbashkët është përgjegjësi edhe e komunitetit.

a. Pamje e një rrugice në Lukovë, me kanale të hapura në anë të rrugës për grumbullimin e ujërave të shiut. Në varësi të terrenit dhe shpateve të rrugëve, kanalet e hapura shpeshherë ndodhen në të majtë apo të djathtë, por edhe në të dyja anët e rrugëve.

b. Një rrugicë me shkallë në Lukovë. Kur portat e oborrit janë në anë të kanaleve të hapura, ndodh shpesh të shtohet një gur i vogël apo platformë betoni, për të lidhur rrugën me shtëpinë.

c. Rrugë me shkallare dhe e shtruar me gurë në fshatin Vuno. Në pjesën e sipërme të portës, në të djathtë, ndodhet një depozitë uji, e cila nuk duhet të vendoset si në këtë foto.

d. Portë oborri në Ilias, ku ndriçuesit janë të vendosur në krye të kornizës së portës.

e. Një rrugicë me shkallare në Ilias. Vihen re bimët dhe lulet, që dalin mbi rrugë duke mbuluar kalimin.

f. Pamje e një rrugice në Lukovë. Llambat e rrugës janë të vendosura në shtylla betoni, të cilat përdoren dhe për të mbajtur kabllot e transmetimit të energjisë elektrike.

g. Një rrugë në Himarë, pranë një kompleksi të rrënuar. Shpesh shtëpitë në Jug janë të vendosura në anë të rrugëve dhe për këtë arsye banesa ka një mur me rrugën. Në këto raste, në katin përdehes nuk ka hapje në fasadën e orientuar nga rruga.







3. Banesa



a. Një banesë tradicionale në fshatin Qeparo, përfaqësuese tipike e tipologjisë së dytë të banesës. Është e dukshme që disa restaurime janë kryer gjatë periudhës socialiste, e disa të tjera janë të viteve të fundit.

b. Pamje e pjesshme e fshatit Dhërmi, që paraqet shumëllojshmërinë e banesave të vendosura në terren kodrinor.

c. Një banesë e tipologjisë së parë në Himarë, me shkallët e jashtme që të çojnë në hapësirën e banimit në katin e parë. Hyrja e katoit është e mbuluar me gurë dhe banesa duket e braktisur.

Banesat në fshatrat e rajonit bregdetar jugor janë të thjeshta dhe jo të përmasave të mëdha. Ato janë zakonisht dy katëshe dhe me çati të pjerrët. Banesa i përshtatet terrenit mbi të cilin ndërtohet, gjë që ka sjellë organizime të ndryshme të oborrit dhe dhomave. Gjithsesi, përmasat dhe format e banesave nuk ndryshojnë shumë nga njëra në tjetrën. Çatitë kanë po ashtu forma të ngjashme, duke krijuar një tablo harmonike të vendbanimeve.

Banesat në fshatrat e rajonit bregdetar janë zakonisht dy katëshe. Ka dy tipologji kryesore: *banesa me kat* ose *gjysmëkat* dhe *banesa e Bregut*.

Në *banesat me kat* ose *gjysmëkat*, kati përdhes (*kato*) është më i ulët se kati i parë. Në këtë tipologji, banesë me kat quhet banesa në të cilën kati përdhes dhe kati i parë kanë të njëjtat përmasa. Ndërsa banesë me gjysmëkat, ajo ku kati i parë është i vendosur pjesërisht përdhe dhe pjesërisht mbi katin përdhes, për shkak se ndërtimi mbështetet në truall të pjerrët dhe organizimi i banesës është i fragmentuar. Në këtë rast kati përdhes ka përmasa më të vogla se kati i parë.

Në të dy llojet e banesave, kati përdhes shërbente si *katua* për mbajtjen e bagëtive, por edhe si *qilar* për ushqimet, ndërsa kati i parë përdorej për të jetuar. Shkallët mund të jenë të vendosura në pjesën e jashtme, në fasadën kryesore ose më në brendësi. Dritaret janë më të mëdha në katin e parë, ndërsa në katin përdhes si rregull janë shumë të vogla, meqenëse ai nuk përdoret për jetesë.

Tipologjia e dytë, të emërtuar *banesa e Bregut*, është më e zhvilluar krahasuar me të parën dhe filloi të përdorej në një periudhë më të vonshme, duke filluar nga mesi i shek. XIX deri në çerekun e parë të shekullit XX. Kjo tipologji është përgjithësisht dy katëshe. Të dyja katet kanë funksion banimi dhe të njëjtën lartësi. Në raste të veçanta, ka edhe banesa me tri kate. Kati i parë dhe i dytë përdoren si hapësira për të jetuar, ndërsa kati përdhes përdoret si qilar për mbajtjen e ushqimeve. Strehimi i bagëtive bëhej në mjedise jashtë banesës. Kjo banesë ka kompozim simetrik dhe në qendër të kompozimit ndodhen





3. Banesa

dy mjedise të ndërlidhura mes tyre. Shkallët janë të pozicionuara brenda banesës. Në këtë tipologji, ka edhe raste banesash me dy oxhakë.

Megjithatë, disa shtëpi kanë karakteristika të tjera ose ndryshime të vogla, nga dy tipologjitë kryesore të përshkruara më lart. Kjo është kryesisht e kushtëzuar nga terreni, në të cilin ato janë vendosur. Ka raste kur për shkak të terrenit ose në rastet e shtëpive të familjeve të pasura, të dyja tipologjitë e banesave kanë tri kate. Në këtë rast, siç është përmendur më parë, lartësia e katit përdhës është shumë e ulët dhe ai përdoret si qilar ose katua, ndërsa dy katet e tjera përdoren si hapësira banimi.

Në disa fshatra ka edhe një tip tjetër banese, që emërtohet *banesë-kullë* (banesë e fortifikuar), e cila është strukturë tipike mbrojtëse. Ka dy raste të kësaj tipologjie: *banesa me një kullë* dhe *kulla*. Në rastin e parë, banesa ka dy elemente të ndara: banesën për jetesë dhe kullën bashkëngjitur saj. Kulla është zakonisht tri katëshe, ndërsa pjesa tjetër është një banesë dykatëshe. Në tipologjinë e dytë, vetë banesa është kullë tri kate e lartë, me dritare shumë të vogla në të gjitha muret dhe me shumë hapje të tipit frëngji, si rasti i kullës në Dhërmi.

Zgjidhjet teknike janë bërë sipas rastit konkret, bazuar në mundësinë e gjetjes së materialeve, si për shembull në rastin e mureve prej guri, që kanë në përbërjen e tyre binarë druri, tipik për rajonin dhe që i japin ndërtesës karakteristika antisizmike (shih 3.3 Muret, faqe 57).

Në ndërtimin e banesave tradicionale shqiptare, janë përdorur materialet natyrore si gëlqerja, argjila për tjegullat dhe gurë. Gëlqerja është nxjerrë nga djegia e gurit gëlqeror. Kjo teknikë është përdorur tradicionalisht në të gjithë Shqipërinë.

Sfida të përgjithshme

Veçanërisht pas viteve 1990, sfidat kryesore që hasen për këto banesa lidhen me ndryshimet që u janë bërë ndërtesave, me braktisjen e shndërrimin në



a. Një banesë dykatëshe me kullë në Dhërmi. Dritaret në tipologjinë e *banesës kullë*, janë më të vogla se në banesat e tjera.

b. Një banesë e tipologjisë së *banesës së Bregut* në Dhërmi, e pozicionuar drejt e në rrugë. Duket se janë bërë ndryshime në banesë, të tilla si kanata të reja plastike ose duralumini, mbyllje të dritareve me tulla etj.

c. Një banesë njëkatëshe në Dhërmi, e ndërtuar me materiale tradicionale, e lëyer me gëlqere të bardhë dhe me tjegulla prej argjile. Banesa, si shumë të tjera në këtë rajon, është e pozicionuar në mënyrë të tillë që të ketë pamje drejt detit.





d. Pamje e një banese në Himarë, e restauruar kohët e fundit. Hapjet e fasadës duken të ndryshuara. Ato janë zmadhuar dhe janë përdorur korniza dritarësh plastike. Është përdorur veshje prej guri për të mbuluar fasadën, e cila nuk rekomandohet.

e. Një banesë e tipologjisë së Bregut, në Qeparo. Restaurimi i çatisë është bërë kohët e fundit, duke ruajtur formën tradicionale, por tjegullat nuk janë në formën dhe ngjyrën origjinale. Duket sikur ballkoni është hequr.

f. Foto nga fshati Dhërmi, që paraqet banesat e restauruara së fundmi. Ndërrhyrjet e kryera janë restaurim i çatave, fasadave, vendosje e dritareve, dërve dhe kanatave të reja.

rrënojë të mjaft prej tyre kryesisht për shkak të emigracionit, por edhe për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së tyre.

- Në këto banesa shpesh janë bërë modifikime në strukturat ekzistuese, duke u ndryshuar formën apo duke bërë shtesa të reja, të cilat shpesh kanë rezultuar në ndryshimin tërësor të përmasave tradicionale të tyre.

- Ndërtesat e reja ose shtesat, për t'i përdorur për shembull si shtëpi pritëse, shpesh herë tejkalojnë lartësitë dhe madhësitë e shtëpive karakteristike të fshatit, duke prishur pamjen e përgjithshme të harmonishme të tij.

- Elemente moderne, si për shembull vetrata të mëdha, struktura beton-armeje dhe çati të sheshta, nuk janë elemente tradicionale të fshatrave.

- Ndërtesat janë të vogla për përdorimet aktuale ose ato të pritshme në të ardhmen.


Rekomandime të përgjithshme


- Për të katërta fshatrat e shpallura si qendra historike, Rregullorja përcakton qartas se lartësia e strukturave të reja ose e objekteve të rikonstruara brenda qendrës historike, nuk duhet të kalojë lartësinë maksimale të ndërtesave ekzistuese.

- Çdo ndryshim i bërë rishtas në hapësirat e brendshme (në ndërtesat monumente kulture, nuk lejohet ndryshimi i hapësirave të brendshme) nuk duhet të shfaqet në pjesën e jashtme. Nëse ka nevojë për hapësira të reja, ato mund të ndërtohen të futura në terren. Përmasat e jashtme të dritareve dhe dërve nuk duhen ndryshuar (Shih 3.5 Dritare, faqe 63 dhe 3.6 Porta dhe Dyer, faqe 73).

- Ndërtesa më të mëdha mund të krijohen duke grupuar disa ndërtesa më të vogla me lidhje të brendshme mes tyre.









3.1 Oborret



- a. Një oborr në Lukovë, ku muret janë të gjitha të lyera me gëlqere të bardhë, siç është tradita e fshatit. Shtrimi me beton është një element i shtuar gjatë socializmit.
- b. Një rrugicë hyrëse në oborrin e një banese në Nivicë. Degët e rrushit krijojnë një pjergullore në rrugë, ndërsa degët e vëna mënjatë janë rezerva druri për zjarr.
- c. Një oborr me tarracime në Palasë, i mbjellë me perime, fruta dhe bimë të ndryshme.

Oborret janë përgjithësisht të pozicionuara në pjesën e përparme të shtëpisë. Gjithsesi, në rastet kur banesa është e vendosur në anë të rrugës, oborri ndodhet në pjesën e pasme. Për shkak të terrenit të shkallëzuar të këtyre fshatrave, pjesa e pasme e banesës gjendet shpesh e futur në tokë, duke iu përshtatur terrenit. Në raste të tilla, oborret janë të vendosura në pjesën e përparme ose anësore të ndërtesës.

Oborri tradicionalisht ka pasur tri funksione kryesore: për gatim, si kopsht me lule e pemë dhe si verandë. Oborret konsiderohen si qendër e jetës në banesë. Tradicionalisht, oborri është përdorur edhe si hapësirë për përpunimin e prodhimeve bujqësore (pastrim, tharje etj.). Kjo traditë vazhdon edhe në ditët e sotme, ndonëse banorët tani i përdorin oborret më shumë si vende për të pushuar e çlodhur, për të biseduar me fqinjët dhe për të mbjellë bimë e lule. Ata nxjerrin jashtë karrige, stola dhe tavolina, ku rrinë për të kaluar kohën e lirë. Historikisht edhe tualetet kanë qenë të vendosura brenda hapësirës së oborrit. Struktura e tyre ishte e thjeshtë, e ndërtuar me gurë (në disa raste shumë të hershme, vihet re dhe përdorimi i qerpiçit). Çdo banesë e ka një oborr, sado të vogël, edhe në rastet kur muret e banesës janë drejt e në rrugë.

Muret rrethuese

Shumica e mureve rrethuese të oborreve janë të ndërtuara me gurë gëlqerorë në të thatë. Kur nuk janë në të thatë, janë të lidhura me llaç gëlqereje. Në pjesën e sipërme, është vënë një shtresë gurësh vertikalë të mbuluar me llaç *horasani*, (llaç i përbërë nga gëlqere e përzier me pluhur tulle) për të mbrojtur muraturën nga shiu dhe kushtet klimatike. Muret janë mjaftueshëm të larta për të garantuar sigurinë dhe privatësinë e banorëve. Ato ndjekin linjat e topografisë dhe shpesh funksionojnë edhe si mure mbajtëse për terrenin.

Shtrimi dhe gjelbërimi

Tradicionalisht oborret janë të shtruar me kalldrëm. Gjatë periudhës socialiste banorët shpesh kanë përdorur edhe beton. Ka raste kur shumica





3.1 Oborret

e sipërfaqes së oborrit është e shtruar, por ka edhe raste kur shtrohet vetëm një rruginë që lidh portën e jashtme me hyrjen në banesë, ndërsa pjesa tjetër përdoret për mbjelljen e bimëve të ndryshme. Bimët tipike të kësaj zone janë pemët frutore si fiqtë, agrumet, rrushi, shegët, dardhat etj., erëzat dhe bimët mjekësore si borzilok, rozmarinë, mente, dafinë, rigon, çaj etj., si edhe perime të llojeve të ndryshme.

Sterat dhe pusët

Sterat përdoren për mbledhjen e ujit të shiut. Ato vendosen në oborr ose në mjediset e brendshme të banesës, në katin përdhes apo pranë katoit. Muret e brendshme të sterës janë mure të trasha, të suvatuara me llaç *horasani*, i cili ndihmon në izolimin e tyre. Pjesa e brendshme e sterës ka një grykë në formë pusi dhe pjesa e poshtme që mbledh ujin është zakonisht e ndërtuar me qemerë guri. Sterat furnizohen nga uji i shiut nëpërmjet tubave prej qeramike. Duke qenë se furnizimi me ujë të pijshëm ka qenë problematik për disa nga fshatrat e zonës, banorët kanë përdorur edhe pusët. Pusi zakonisht hapej në mesin e oborrit. Pusët janë më të paktë krahasuar me sterat.

Materialet dhe teknikat

Sfida

- Shtrimi i oborreve shpesh është bërë me beton, i cili pengon drenazhimin natyral dhe iu jep një pamje jo tërheqëse këtyre hapësirave tradicionale.
- Janë shtuar struktura të papërshtatshme metalike ose plastike, për të krijuar hije apo streha. Shkallët e jashtme, të ndërtuara rishtazi për të lidhur oborrin me katet e sipërme, janë me materiale të papërshtatshme betoni ose metali, dhe shpesh mbulojnë gjithë fasadën dhe elementet tipike të saj.
- Drenazhimi është një tjetër sfidë për oborret. Tradicionalisht, përreth oborreve janë ndërtuar kanale për të mbledhur ujin e shiut, që derdhet nga çatia në kanalet e rrugës ose në sterë. Shpesh, këto kanale nga mungesa e mirëmbajtjes janë të bllokuara dhe shiu përmbyt oborret.



a. Një oborr në Vuno. Shtrimi me gurë kalldrëmi është ruajtur shumë mirë dhe hapësira është zbukuruar me një bollëk lulësh, erëzash dhe bimësh mjekësore të mbjella në oborr.

b. Një oborr në fshatin Himarë. Shtrimi me gurë është ruajtur shumë mirë. Shkallët në plan të parë të çojnë në verandën e banesës.

c. Një pus në oborrin e pasmë të një banese në Ilias. Një pompë elektrike furnizon banesën me ujë nga pusi.

d. Kompleks banimi në një terren të sheshtë, i përbërë nga dy ndërtesa. Oborri është i shtruar me kalldrëm dhe ka dy hyrje.


e. Kompleks banimi në një terren kodrinor, i përbërë nga dy banesa të ndërtuara në periudha të ndryshme kohore.



b.



c.



d.



e.

3.1 Oborret

- Tualetet dhe kuzhinat e ndërtuara në oborre janë të papërshtatshme shpesh shumë të vjetruara, jo praktike dhe dëmtojnë funksionin çlodhës dhe argëtues të oborrit.

- Bimët tradicionale shpesh zëvendësohen me bimë, që nuk i përkasin këtij rajoni. Gjithashtu ndodh që edhe kur mbillen, për shkak se banorët nuk jetojnë aty gjatë gjithë vitit, ato nuk trajtohen me kujdes dhe thahen, duke i lënë oborret pa gjallëri dhe jetë.

Rekomandime

- Inkurajohet mundësia për të vendosur tualetet dhe kuzhinat në hapësirat e brendshme të banesave, pa bërë ndërhyrje në strukturën e ndërtesës dhe fasadë. Përndryshe, duhet gjetur një zgjidhje, për t'ia përshtatur situatës konkrete, e cila nuk duhet të dëmtojë pamjen e banesës. Për banesa të cilat nuk janë monumente kulture ose në zona - qendra historike, tualetet mund të vendosen edhe ngjitur me banesën. Në këtë rast, shtesat e reja duhet të dallohen që janë ndërtim i ri. Kjo mund të bëhet duke përdorur materiale bashkëkohore ose në rast përdorimi të materialeve të njëjta me ndërtimin ekzistues, shtesa duhet të ketë një nënshkrim, për ta dalluar që është ndërtim i ri (një datë apo simbol). Në të dyja rastet, shtesa duhet të vendoset në pjesën e pasme të banesës dhe të mos tejkalojë lartësinë e katit.

- Struktura të tjera shërbimi (si p.sh. depo) duhet të vendosen në pjesën e pasme të oborrit dhe sërish të ndërtuara në lartësi jo më të madhe sesa muret e oborrit.

- Gurët për kalldrëm duhet të jenë nga guroret pranë fshatit. Nuk duhet përdorur beton për shtrimin, por rërë, në mënyrë që uji të mund të filtrojë. Kalldrëmi është mënyrë më e mirë për shtrimin e oborreve. Për shtrimin mund të përdoren edhe materiale të tjera si: druri, trungje pemësh dhe pllaka guri. Në çdo rast, kini parasysh që të bëni nivelimin e duhur, në mënyrë që të shmanget rrjedhja e ujit drejt ndërtesës.

-Për struktura strehe dhe hijeje, materialet më të mira janë druri dhe kashta.



a. Një oborr në Qeparo siç shihet nga porta kryesore e banesës. Autor: Herve Loiselet.

b. Oborri i Hotel Osumit në Berat. Ky është një shembull i mirë sesi mund të përshtaten elementet e oborrit, për të kryer edhe funksione të tjera, si kafe apo restorant.

c. Oborri i Hotel Gjrokastrës në qytetin me të njëjtin emër. Shtrimi me gurë dhe sistemimi i bimësisë krijojnë një mjedis të përshtatshëm në një hapësirë që funksionon si bar dhe restorant i jashtëm për hotelin.



VINI RE!

- **NUK rekomandohet përdorimi i gurëve me ngjyra të forta për shtrim.** Inkurajohet përdorimi i gurit të terrenit vendas, ngjyrat e të cilit variojnë mes bezhës dhe grisë.
- **NUK rekomandohet përdorimi i betonit si material shtrimi.** Inkurajohet të mos përdoren materiale, që bllokojnë kullimin e ujit. Këshillohet të përdoret rrëzë dhe zhavorr në vend të betonit. Lini hapësira boshe për bimë dhe drenazhim natyral.
- **NUK rekomandohet mbulimi i sipërfaqes së oborrit me struktura të reja.**
- **NUK rekomandohet prishja apo ndryshimi i mureve dhe i elementeve tradicionale të oborrit.**
- **Nuk rekomandohet ndërtimi i strukturave të reja në oborr, nëse shtëpia juaj është monument kulture apo brenda një qendre të mbrojtur.**

Strukturat mbështetëse duhet të jenë sa më të lehta. Këto struktura nuk duhet të mbulojnë më shumë se gjysmën e krejt sipërfaqes së oborrit dhe jo më të larta sesa muret rrethuese.

- Siguroni funksionimin e plotë të tubave, kanaleve dhe vijave kulluese. Kur është e mundur, mirëmbani sistemet e vjetra të drenazhimit. Për të shmangur përmytjen e oborrit në raste reshjesh, lidhni tubat dhe kanalet kulluese në oborr me kanalet kryesore në rrugë ose drejtpërdrejt me sterat.

- Rekomandohet vënia e pushtave në vende jo të dukshme dhe përdorimi i kapakëve në përshtatje me shtrimin. Përdorni kapakë metalikë, jo plastikë.

- Muret rrethuese duhen ndërtuar me gurë të terrenit përreth dhe mbi to të vendoset një radhë gurësh vertikalë të mbuluar me llaç horasani, për të mbrojtur muraturën nga uji dhe faktorë të tjerë klimatikë.

- Duhen mbjellë vetëm bimë të vendit. Kur është nevoja e përdorimit të vazove, më e mira është përdorimi i vazove prej balte dhe jo plastike. Gjellbërimi dhe mbjellja e bimëve të ndryshme në oborr zbukuron ndjeshëm pamjen e banesës, përmirëson mikroklimën, krijojnë hije dhe kontribuon në ekonominë e vogël shtëpiake.

d. Oborri i përpamë i një banese në fshatin Vuno. Është përdorur një strukturë metalike e thjeshtë për të mbështetur hardhitë e rrushit, të cilat krijojnë hije në hapësirat e shtruara me gurë.

e. Një oborr me pamje piktoreske në Vuno. Bimësia e mbështetur në një strukturë metalike krijon strehë dhe hije.





3.2 Fasadat



a. Një banesë dykatëshe e ndodhur në anë të rrugës kombëtare në Vuno. Kornizat e dritares të lëra me ngjyrë të gjelbër nuk janë tipike për këtë rajon, por në këtë rast ato i shtojnë vlerë estetike fasadës.

b. Një banesë e tipologjisë së *banesës me kat* në Qeparo. Kati përdhes, katoi, përdoret për magazinim dhe mbajtjen e bagëtive, ndërsa kati i parë si hapësirë jetese.

c. Një banesë e tipologjisë së Bregut në Dhërmi. Kjo banesë dykatëshe ka një ballkon në pjesën qendrore të fasadës në katin e parë. Ballkoni ka pamje nga deti.

Kompozicioni urban i banesave nuk ndjek ndonjë rregull të përcaktuar, por është organizuar në varësi të kushteve të terrenit konkret dhe të orientimit nga dielli. E njëjta gjë haset edhe në organizimin dhe orientimin e fasadës kryesore. Vihet re shpesh një parapëlqim i dukshëm për orientimin e fasadave kryesore nga jugu, edhe pse jo gjithnjë është e mundur, për shkak të topografisë ose të marrëdhënies së banesës me rrugën. Në disa raste, fasada kryesore është drejt e në rrugë ose mbi të. Nëse nuk është nga rruga, fasada kryesore e banesës kthehet në elementin mbizotërues në oborr. Për arsye se ekzistojnë dy tipologji banesash (siç është përshkruar në kreun 3. Banesa, shih faqen 31) ka edhe dy tipologji kryesore fasadash.

Tipologjia e parë e fasadës është zakonisht me suva në katin parë dhe jo e suvatuar në atë përdhes. Dritaret, zakonisht, janë më të mëdha në katin e parë. Për shkak se kati përdhes është më i ulët dhe nuk përdoret për banim, dritaret shpesh janë shumë të vogla.

Në tipologjinë e dytë, të dyja katet përdoren për banim dhe kanë të njëjtën lartësi. Fasada ballore ka kompozicion simetrik dhe dritare drejtkëndore, në pozicion vertikal, të kornizuara me gurë të gdhendur, me të njëjtën madhësi në të dy katet. Hapësira midis dritareve është zakonisht 1.5 – 2 herë më e madhe sesa gjerësia e dritares. Në disa raste ka edhe një ballkon të vogël në katin më të lartë në mes të fasadës dhe me pamje nga deti. Në tipologjinë e dytë, ka raste kur banesa ka tri kate. Në këtë rast, fasada e katit të dytë është e njëjtë me atë të katit të parë.

Fillimisht, fasadat nuk kanë qenë të suvatuara, por prej fillimit të shek. XIX e gjithë fasada ose vetëm kati i parë suvatohej me gëlqere, por në të dy rastet, qoshet e murit liheshin të pa suvatuara në secilën prej anëve të fasadës. Tradicionalisht, në suvatimin e fasadave është përdorur një shtresë shumë e hollë suvaje (deri në një gisht) që vendosej në pjesët anësore të gurit të muraturës. Kjo ndihmon në mbrojtjen e gurëve dhe në të njëjtën kohë shmang mbulimin e plotë të tyre.





3.2 Fasadat

Muratura e qosheve në shumicën e rasteve është e përpunuar me kujdes dhe e pajisur me detaje dekorative të gdhendura në gur. Këto elemente dekorative janë floreale ose gjeometrike. Në disa raste aty shënohet dhe viti i ndërtimit të banesës. Ato janë elemente me rëndësi të fasadës si edhe të ndërtesës në tërësi. Në fasadën e disa banesave, vihen re disa hapje të vogla në formë drejtkëndëshi. Ato janë vendet ku kanë qenë vendosur skelat e drurit gjatë ndërtimit të banesës.

Shkallët e jashtme janë një tjetër element me rëndësi, tipik për fasadën e banesës së tipologjisë së parë (*banesa me kat ose gjysmëkat*). Ato janë ndërtuar me gurë dhe shpesh janë të bardha, të lëra me gëlqere. Që prej viteve '50-të të shekullit të kaluar dhe më pas, shumë banorë i zëvendësuan këto shkallë, me shkallë betoni. Në tipologjinë e parë të banesës (*banesa me kat ose gjysmëkat*), shkallët e jashtme të çojnë në verandën e katit të parë.

Sfida

- Fasadat janë të prirura për të shfaqur probleme. Në njërën anë qëndrojnë problemet që lidhen me çështje teknike, si përdorimi i materialeve të papërshtatshme, mungesa e përvojës në ndërtim apo në punë restauratore. Nga ana tjetër, pronarët e shtëpive duke dashur t'i përshtatin ato me standardet dhe kushtet bashkëkohore, në shumicën e rasteve fillojnë dhe ndryshojnë elementet tipike të fasadave, si veshjen e murit, dyert, dritaret, çatinë (e ashtuquajtur "fasada e pestë" e banesës) etj.

- Probleme të tjera dalin nga përdorimi i betonit të fortë ose llaçit me përbërje çimentoje në muraturat natyrale prej guri. Përdorimi i çimentos mund të dëmtojë muraturën dhe ajo mund të përkeqësohet ose të plasaritet, duke lejuar ujin të depërtojë në muraturë dhe ta dëmtojë nga brenda.

- Shpesh, për lyerjen e mureve të jashtme përdoren bojërat e sotme sintetike, të cilat janë shumë të dendura dhe nuk zgjasin shumë. Gjatë viteve të fundit,



a. Një banesë me dy kate në fshatin Himarë, me dritare dhe dyer plastike, të cilat nuk duhen përdorur në këtë rajon për shkak se shkaktjnë probleme teknike dhe estetike.

b. Një banesë me tri kate në Dhërmi, me shenja të dukshme përkeqësimit në fasadë.

c. Një banesë në Piqeras, me mure të suvatuara me teknikën e njohur si *grafiato*, e cila nuk është e rekomandueshme. Qoshet e mureve të banesës janë lënë të ekspozuara, por jo në mënyrë tradicionale dhe po ashtu edhe oxhaku nuk ka tipare tradicionale.





d. Një banesë në Ilias. Antena dhe kondicionerët e vendosur në fasadën kryesore të ndërtesës, dëmtojnë pamjen estetike të ndërtesës dhe të fshatit në tërësi.

e. Një banesë në Qeparo. Punimi me gurë i qosheve është lënë i ekspozuar, ndërsa pjesa tjetër e fasadës është e suvatuar me suva shumë të trashë dhe të dendur, ndryshe nga shtresa e hollë tradicionale e suvasë, e cila lejon muraturën të jetë lehtë e dukshme dhe më e rëndësishmja, të marrë ajër.

ngjyrat e përdorura për lyerjen e fasadave nuk janë në përshtatje me ngjyrat e përdorura në zonë. Përgjithësisht janë shumë të forta (p.sh. shumë të errëta ose neon) dhe dëmtojnë imazhin e harmonishëm të fshatit.

- Kabllot dhe pajisjet e ndryshme moderne (antenat, kondicionerët, panelet diellore etj.) përbëjnë një sfidë për sa i përket vendosjes së tyre në mënyrë të tillë që të mos dëmtojnë pamjen e përgjithshme të fasadave.

- Në fasadë vendosen drita apo llamba të ndryshme për të ndriçuar rrugën apo oborrin. Forma e këtyre ndriçuesve shpesh imiton modele të vjetra ndriçuesish, por që në fakt, nuk janë tradicionale për këto fshatra.


- Mungesa e strehës në derën e hyrjes së banesës. Edhe pse mund të mos jetë traditë përdorimi i tyre, ato janë jashtëzakonisht të rëndësishme për të mbrojtur derën nga kushtet e motit. Gjithsesi, në shumë raste, banorët vendosin streha, të cilat janë krejt në shpërpjesëtim me fasadën (shumë të mëdha) ose përdorin materiale që nuk përshtaten si duhet me fasadën e ndërtesës (p.sh. prej plastike).

Rekomandime

- Nuk rekomandohet hapja e dritareve të reja në fasadë. Gjithsesi, ju duhet të konsultoheni me autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore (DRKK ose Bashkia Himarë) dhe nëse merrni leje për hapje të reja, ato duhet të jenë në përshtatje me përmasat, formën dhe materialet e përdorura për ato tradicionale. Çdo dritare apo derë e re duhet të ketë të njëjtat karakteristika (material, formë, përmasa) me dritaret apo dyert tradicionale.

- Materialet më të përshtatshme janë ato tradicionale: gëlqerja për llaçin dhe suvanë dhe bojërat me gëlqere në ngjyra toke për lyerje, të cilat janë të lehta për t'u përdorur dhe jo të shtrenjta.

- Muratura në qoshe, qemerët dhe hapja e dritareve apo dýerve duhen bërë me kujdes të veçantë. Heqja e suvasë së fasadës gjatë punimeve ose





3.2 Fasadat

rinovimeve duhet bërë me dorë dhe jo duke përdorur makineri të rënda. Zakonisht, nuk është i nevojshëm përdorimi i kimikateve për mbrojtjen e sipërfaqeve të fasadave të ndërtuara me materiale tradicionale.

- Nëse do të bëni ndryshime në fasadë, ato duhet t'i përshtaten përmasave tradicionale të dymëve, dritareve dhe elementëve të tjerë (Shih 3.4 Porta dhe dym, faqe 63 dhe 3.5 Dritare, faqe 73).

- Për suvanë, këshillohet të përdoret gama e vogël e ngjyrave tradicionale, si për shembull ngjyra toke apo pasteli. Duhet shmangur sa më shumë ngjyrat e forta apo fluoreshente, pasi dëmtojnë estetikën e fshatit (shih paletën e ngjyrave, faqe 51).

- Ulluqet vertikale dhe horizontale duhen bërë prej alumini xingat ose bakri. Ndikimi në fasadë duhet të jetë sa më i vogël. Kur nuk është i mundur përdorimi i aluminit xingat ose i bakrit, tubat duhen lmyer me ngjyrë sa më të ngjashme me fasadën.

- Elementet që shtoni, si p.sh. kondicionerët, vendosini në mënyrë sa më të padukshme. Këshillohet vendosja e tyre në fasadën e pasme ose mbulimi me panele metalike të lmyera në të njëjtën ngjyrë si fasada.

- Rekomandohet vendosja e kabllave të televizorit në mënyrë horizontale, poshtë strehës ose vertikale në mur. Mirë është që kabllot të lmyen me të njëjtën ngjyrë si fasada, p.sh. me ngjyrë të zezë ose gri kur ato janë mbi mure guri dhe të bardhë ose gri në muret me suva.

- Ndriçuesit në fasadë nuk duhet të imitojnë ndriçues të vjetër jo tradicionalë për këto zona. Ata duhet të jenë sa më të thjeshtë, të tregojnë qartas që janë elemente bashkëkohore dhe të vendosen në mënyrë të tillë që të mos dëmtojnë pamjen e fasadës.



a. Një banesë në Lukovë. Fasada e katit të parë është e suvatuar ndërsa në pjesën e poshtme, në katin përdhës, guri është lënë i ekspozuar.

b. Një banesë në Pulia, Itali me kabllot e vendosura horizontalisht dhe vertikalisht në fasadë. Në vendosjen e tyre nuk është treguar kujdesi i duhur, pasi ato dëmtojnë pamjes estetike të fasadës.

c. Vizatim i një banese tipike të tipologjisë së parë (banesa me kat). Hyrja në katin e parë të banesës bëhet me anë të shkallëve të jashtme prej guri.

d. Vizatim i një banese të tipologjisë së dytë (banesa e Bregut). Fasada është e suvatuar dhe vetëm gurët në qoshe janë lënë të ekspozuar.

e. Vizatim i një banese të tipologjisë së dytë (banesa e Bregut). Fasada është pothuajse tërësisht e suvatuar dhe vetëm gurët në qoshe janë lënë të ekspozuar.




b.



c.



d.



e.



3.2 Fasadat



a. Foto kolazh me lloje suvatimesh dhe lyerje të ndryshme. Lyerja e fasadave me gëlqere të bardhë vihet re shpesh në fshatra, edhe pse në shumë raste përdoret llaç me ngjyrë (si në rastin e ndërhyrjeve bashkëkohore në fshatin e Kudhësit; imazhi majtas, lart) apo dhe direkt lyerja e gurëve në muraturë (rasti i Vunoit; imazhi majtas, poshtë).



a.

VINI RE!

- **NUK rekomandohet përdorimi i materialeve jo tradicionale të ndërtimit si p.sh. suvaja me çimento, suvaja me llak ose elemente prej polisteroli.**
- **NUK rekomandohet vendosja e pajisjeve të kondicionerëve në fasadën kryesore. Mos vendosni në fasadë antena të thjeshta ose satelitore (kur është e mundur gjeni një zgjidhje të përbashkët për marrjen e sinjaleve të transmetimit).**
- **NUK rekomandohet mbulimi i muraturës me shtresë të trashë suvaje.**
- **NUK rekomandohet vendosja e izolimit në fasadë, që të mos mbulohen muret.**
- **NUK rekomandohet heqja e suvasë origjinale nëse është në gjendje të mirë.**
- **NUK rekomandohet heqja e kornizave të dymve dhe dritareve, nëse janë në gjendje të mirë dhe mund të riparohen.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i ngjyrave të forta ose neon, sepse jo vetëm kanë shkëlqim verbues, por edhe dëmtojnë dukshmërinë harmonike të rrugës dhe fshatit.**
- **NUK rekomandohet ndryshimi i strukturës së fasadave historike, duke mbyllur ose hapur dym dhe dritare të reja apo ndërtuar elemente të reja (p.sh. ballkone) ose duke hequr elementet historike ekzistuese.**
- **NUK lejohen ndryshime në pamjen e fasadës nëse shtëpia juaj është monument kulture ose është pjesë e zonës së mbrojtur. Çdo ndërhyrje që mund të bëni në fasadë duhet të miratohet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.**
- **NUK rekomandohet bërja e dritareve të reja në fasadë. Gjithsesi në rast hapjeje, duhet t'i drejtoheni institucioneve përgjegjëse. Nëse jepet leja, është i domosdoshëm respektimi i përmasave, formave dhe materialeve të dritareve tradicionale.**


b. Ngjyrat që këshillohen për t'u përdorur për suvatim dhe lyerje të fasadave të banesave historike, në fshatrat tradicionale të rajonit të Himarës. Kodet e ngjyrave janë dhënë në sistemin RAL dhe sistemin NCS.

RAL 9016 NCS 1950 S 0300-N	RAL 9010 NCS 1950 S 0502-Y50R	RAL 1015 NCS 1950 S 1010-Y40R	RAL 1013 NCS 1950 S 1005-Y40R	RAL 9001 NCS 1950 S 0804-Y70R	RAL 9002 NCS 1950 S 1505-Y50R	RAL 9018 NCS 1950 S 2000-N
RAL 1014 NCS 1950 S 1515-Y20R	RAL 1001 NCS 1950 S 2020-Y20R	RAL 7032 NCS 1950 S 3005-Y20R	RAL 7038 NCS 1950 S 2502-Y	RAL 7074 NCS 1950 S 1502-R	RAL 1000 NCS 1950 S 2020-G90Y	RAL 7044 NCS 1950 S 2502-Y
RAL 1017 NCS 1950 S 1050-Y30R	RAL 1034 NCS 1950 S 2050-Y30R	RAL 2012 NCS 1950 S 2060-Y70R	RAL 3012 NCS 1950 S 3030-Y60R	RAL 3014 NCS 1950 S 2040-R	RAL 1019 NCS 1950 S 4010-Y30R	RAL 4009 NCS 1950 S 4010-R30B

b.



3.2 Fasadat



a. Shkrimi me shkronja të ndara me hapësira, rekomandohet të përdoret për tabelat e vendosura në dyert kryesore (siç dhe ilustruhet në figurë).


b. Një tabelë prej bakri dhe çeliku, e varur në një mur guri. Këto materiale moderne kanë peshë të lehtë dhe gjenden lehtësisht. Tabelat vendosen lehtësisht në mure guri me anë të bulonave apo gozhdëve metalike. Është e rëndësishme që në çdo rast të respektohen specifikimet në lartësi dhe në përmasa të tabelave, të shpjeguara edhe në figurën më poshtë.

c. Një tabelë prej druri në Dubrovnik, Kroaci. Dekorimet e gdhendura i shtojnë vlerë fasadës.

d. Specifikimet që duhet të respektohen kur shtohen tabela sinjalizuese të varura në fasadë.

e. Tabelë e vizatuar me dorë në Polignano, Itali, vendosur në mur duke përdorur gozhdë të thjeshta metalike, të cilat kapen në fugaturat e llaçit për të mos dëmtuar muraturën.

f. Tabelë prej metali dhe druri në Gjirrokastër, me tipografi të thjeshtë informuese, e cila është një referencë e mirë.



VINI RE!

- **NUK rekomandohet përdorimi i tabelave LED, me drita me shkëlqim të fortë, reflektuese apo që pulsojnë pa reshtur.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i dritave me shumë ndriçim ose fluoreshente.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i materialit akrilik plastik, etj.**
- **NUK rekomandohet vendosja e tabelave që mbulojnë dritaret apo dyert.**
- **NUK rekomandohet mbulimi me tabela reklamash i elementeve të rëndësishme arkitektonike ose i detajeve dhe ornamenteve të fasadës së ndërtesës.**
- **NUK rekomandohet vendosja e reklamave, tabelave të mëdha ose posterave në fasadë.**

Tabelat

- Në rastet kur lind nevoja për të ndryshuar funksionin e një ndërtese në një biznes, elementet e brendimit, si p.sh. tabelat, duhen përdorur në mënyrë të kujdesshme, veçanërisht kur kemi të bëjmë me ndërtesa historike.
- Është po ashtu e rëndësishme që vitrinat e dyqaneve të dizajnohen të tilla që të integrohen me karakteristikat e pamjes që ka fshati, ngjyrave të tij karakteristike dhe stilit të fasadave.
- Rekomandohet përdorimi i ndriçimit jo të drejtpërdrejtë dhe shmangia e ndriçimit të tepërt.
- Tabelat e dyqaneve duhen vendosur vetëm në fasadën e kateve përdhe dhe duhet lënë një hapësirë mes tabelës dhe dritareve të katit të parë.
- Përdorni tabela metalike ose druri.
- Tabelat që vendosen në mënyrë pingule nuk duhet të jenë më të mëdha se 60 x 40cm, sepse nuk duhet të mbulojnë elementet e fasadës.
- Rekomandohet përdorimi i shkronjave dhe logove me hapësira mes tyre. Stili i shkrimeve duhet të jetë në harmoni me karakterin e ndërtesës. Është e rëndësishme të mos përdoren lloje të ndërlikuara shkrimi dhe të vështira për t'u lexuar.

g. Tabelë e familjes Kliarko në Qeparo. Kjo pllakë prej guri është e fiksuar me gozhdë metali. Shkrimi është gdhendur në mënyrë të thjeshtë në pllakë dhe pastaj është lyer me bojë blu.

h. Tabelë prej metali (çeliku) me shkronja të ndara me lazer. Kjo tabelë e thjeshtë është e parapëlqyer të përdoret, sepse është mjaft estetike dhe nuk e dëmton peizazhin historik tradicional të këtyre vendbanimeve.




g.



h.



3.2 Fasadat



a. Kolazh me foto të tipave dhe materialeve të ndryshme të strehëve. Druri, metali, material cohe, xhami etj., mund të përdoren për të siguruar hije dhe mbrojtje të dymve nga shiu. Mund të përdoren gjithashtu materiale sezonale si kashta apo bari i thatë (si në shembullin e fotos lart, në të majtë).



a.

VINI RE!

- **NUK rekomandohet vendosja e strehëve të mbajtura nga kolona betoni ose guri.**
- **NUK rekomandohet fshehja apo errësimi i elementëve të fasadës si p.sh. mbulimi me strehë i bazo relieveve në gur.**
- **NUK rekomandohet vendosja e strehëve pa siguruar drenazhimin e duhur (p.sh. pjerrësia e strehës duhet të jetë e tillë që uji të mos dëmtojë fasadën).**
- **NUK rekomandohet përdorimi i strehëve apo tendave në dritare. Për të mbrojtur dritaret mund të vendosni kapakët tradicionalë prej druri, të cilët e kryejnë më së miri këtë funksion.**
- **NUK rekomandohet vendosja e strehëve në godina që janë monument kulture. Shtimi i çfarëdolloj elementi në godinat brenda qendrave historike mund të bëhet vetëm pasi është miratuar leja nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.**

b. Tip strehe për derën, e përbërë nga strukturë çeliku dhe mbulesë prej materiali polikarbonati.

c. Strehë e tejdukshme prej qelqi dhe çeliku.

d. Një strehë e varur prej çeliku dhe xhami të temperuar. Kjo tipologji strehe është shumë e thjeshtë dhe moderne, që nuk e rëndon fasadën e banesës. Në shtimin e kësaj strehe është e rëndësishme të siguroheni që paneli prej xhami është i përshtatshëm për këtë funksion dhe ka brenda tij një rrjetë teli apo është xham i laminuar, që në rast dëmtimi të xhamit, thyerja të mos bëhet në copa të mëdha që mund të shkaktojnë lëndime.

Strehët

- Strehët mund të përdoren, por nuk duhet të mbështeten në elemente të rënda si p.sh kolona betoni ose guri. Portikët nuk janë elemente tipike për këtë rajon.

- Materialet që këshillohet të përdoren janë druri ose metali për strukturën, dhe metali, copa ose xhami për mbulojën.

- Ngjyrat duhet të jenë të ngjashme me ngjyrën e fasadës.

- Strehët duhet të jenë jo shumë të mëdha, por në përpjesëtim me fasadën; jo më të gjera se dera (deri në 120cm) dhe jo më të thella se 60cm.

- Nëse në fasadë vendoset më shumë se një strehë, (për shembull një mbi portë dhe një mbi ballkon) ato duhet të jenë të së njëjtës tipologji (në material, ngjyrë, formë dhe madhësi).

- Strehët duhen vendosur ngjitur me arkitraun e portës hyrëse.





a.

3.3 Muret



a. Një banesë me një mur kallkan të suvatuar, në Qeparo.

b. Qoshja e një banese në Himarë, ku dallohet lehtësisht sesi reshjet mund të dëmtojnë muret, duke i lënë gurët të ekspozuar.

c. Skicë me ngjyra e disa banesave në Himarë fshat, ku vihet re ndryshimi midis banesës në pjesën e pasme (me mure të suvatuara) dhe banesës në gjendje rrënojash në të djathtë. Autore: Ani Tashi, gjatë "Sketching Cultural Heritage Workshop" të programit ISDCR/GIZ.

Muret e ndërtesave tradicionale në fshatrat e këtij rajoni janë zakonisht të bëra prej guri gëlqeror, të marrë nga guroret aty pranë. Guri i nxjerrë nga gërmimi, përpunohet dhe përdoret për themelin dhe për muret mbajtëse. Hasen edhe raste kur ndërtesa ngrihet mbi të njëjtin truall, nga i cili është nxjerrë edhe guri. Gurët lidhen me llaç gëlqereje. Druri është një tjetër material i përdorur shpesh për ndërtimin e muraturës. Ai shërben si binar për të përforcuar muraturën dhe për ta bërë atë më elastike, në mënyrë që t'i rezistojë dëmeve të mundshme nga tërmetet. Druri gjendet kudo në Shqipëri, por me cilësi të ndryshme, gjë që ka ndikuar në ndryshimet e metodave tradicionale të ndërtimit nga një krahinë në tjetrën. Llojet më të përdorura të drurit janë plepi, dëllinja dhe mani. Gjithsesi, ka dhe raste kur muraturat janë ndërtuar pa binarë druri, por kjo ka qenë një teknikë shumë e vjetër.

Trashësia e një muri tipik, varion. Mund të jetë 130cm në themele, 100-120cm në katin përdhes, 70-90cm në katin e parë dhe në strehë zvogëlohet me 8-12cm (shih figurën, faqe 57). Kornizat e mureve janë zakonisht të bëra prej guri. Në këto raste, ato ndërtohen me dy shtresa gurësh, secila rreth 5cm, që dalin 5-10cm nga muri. Qoshet e mureve janë zakonisht të përforcuara me blloqe më të mëdha gurësh.

Ka dy tipa të ndërtimit të mureve. Tipi i parë është muratura pa binarë druri. Në këtë tipologji, muri është i ndërtuar me dy shtresa gurësh të vendosura në mënyrë paralele me një hapësirë në mes. Lidhja midis këtyre dy shtresave bëhen me gurë transversalë, të quajtur diatonë dhe hapësira në mes mbushet me gurë të vegjël të thërrmuar. Për murin përdoren gurë të një madhësie përafërsisht të njëjtë dhe me formë të rregullt.

Në tipin e dytë (dhe më të përdorur) të mureve, ka dy shtresa paralele gurësh me një hapësirë në mes, e cila po ashtu mbushet me aggregate. Në këtë rast, ndërlidhja mes dy shtresave të muraturës bëhet duke përdorur binarë druri dhe jo gurë transversalë. Dëllinja është druri i përdorur për brezat e drurit. Në





3.3 Muret

të dyja shtresat e murit vendosen binarë gjatësorë në intervale vertikale 70-100cm, duke filluar nga poshtë-lart. Binarët transversalë vendosen çdo 80 ose 120cm gjatë gjithë lartësisë së murit. Ky përforsim quhet brez, emërtimi i të cilit tregon funksionin që ka druri në mbërthimin e muraturës, ashtu siç armimi me elementë hekuri forcon strukturën e betonit.

Binarët e drurit zakonisht në fasadë nuk janë të dukshëm. Ata fshihen në muraturë për të shmangur ekspozimin në mjediset e jashtme dhe parandaluar dëmtimin e drurit. Binarët janë të dukshëm në pjesën pranë çatisë, duke qenë se mbrohen nga streha e saj. Seksioni i këtyre binarëve është drejtkëndor dhe varion mes 3 x 5cm për binarët transversalë dhe 8 x 15cm për ata gjatësorë. Elementët e drurit bashkohen me gozhdë hekuri. Tipi i dytë i ndërtimit të mureve është më i përparuar, më i qëndrueshëm dhe më i fortë nga tipi i parë.

Sipërfaqet

Muret janë zakonisht të suvatuara me gëlqere. Gjithsesi, ka edhe raste kur muret nuk janë të suvatuara dhe muratura është e ekspozuar. Llaçi i përdorur për të lidhur gurët e muraturës bëhet me gëlqere. Suvatimi i mureve është tipik në fshatrat e bregut të Himarës. Fillimisht përdorej baltë e përzier me ujë dhe kashtë. Më pas, kjo u zëvendësua me gëlqere. Sipërfaqja e suvasë zakonisht është e ashpër. Në raste të tjera, përdoret një teknikë ku suvatohen vetëm pjesët anësore të gurit të muraturës (deri në një gisht). Gurët e muraturës përpunohen me kujdes, por për gurët e qoshes tregohet më shumë vëmendje dhe shpesh kanë edhe elemente dekorative.

Ornamentimi

Ndërtesat në këtë rajon kanë shpesh ornamente të gdhendura në gur apo bazorelieve, të cilat vendosen në qoshet e mureve, mbi dritare apo dyert







a. Pamje nga afër e muraturës së një banese në Kudhës. Punimi i gurit dhe teknika e përdorur për suvatim (teknika e fugatimit, ku vendoset shtresë suvaje përreth gurit deri në një gisht) janë të përshtatshme.

b. Një mur me suva i dëmtuar nga kushtet e motit dhe rrjedha e kohës. Është e rëndësishme të tregohet kujdes i vazhdueshëm për muraturën, si metoda më e sigurt për ta ruajtur atë.

c. Një banesë në Vuno, ku muret e jashtme janë në gjendje të mirë. Megjithatë, nuk inkurajohet mbyllja e hapjeve të dritareve, si në rastin e murit anësor të kësaj ndërtese, sepse mund të depërtojë uji në hapjet e vogla dhe të dëmtojë gurët dhe muret.

d. Vizatime të ndërtimit tradicional të mureve prej guri në këtë rajon.





d.



3.3 Muret

e hyrjes dhe në disa raste, të lyera edhe me gëlqere. Ornamentet mund të jenë bërë edhe me llaç gëlqereje. Këto ornamente kanë motive floreale, gjeometrike ose fetare. Në disa raste, në qoshet e mureve, mbi dritare apo portën hyrëse gdhendet viti i ndërtimit ose detaje të tjera historike.

Sfida

- Një ndër rreziqet më të mëdha që haset në strukturat e mureve është mungesa e mirëmbajtjes së mureve dhe çatisë. Mund të hyjë ujë nëpërmjet hapjeve të çatisë, plasaritjeve të murit ose nëpërmjet fugave, kur llaçi ka rënë. Lagështia që vjen nga poshtë për shkak të aktivitetit kapilar e dëmton muraturën nëse nuk largohet në mënyrën e duhur. Muret me binarë përforcues druri mund të shfaqin probleme, nëse muret nuk thahen mirë dhe binarët e drurit fillojnë të kalben.

- Një tjetër rrezik vjen prej ndërhyrjeve të gabuara teknikisht (edhe pse qëllimet mund të jenë të mira), kur përdoren materiale dhe teknika të papërshtatshme. Në banesat tradicionale nuk duhen përdorur lloje të sotme betoni. Karakteristikat e tij fizike dhe teknike nuk përshtaten me muraturën e gurit natyral. Betoni është shumë i fortë dhe krijon tension mes materialeve të reja dhe atyre të vjetra. Ai nuk ka fleksibilitetin e duhur për t'u përdorur në vende si Shqipëria, që është e prirur për aktivitet sismik.

- Shpesh hiqet suvaja që të duken gurët. Është shumë e përhapur ideja se gurët e ekspozuar janë pamja tradicionale e një fasade, gjë që nuk është e vërtetë. Heqja e suvasë aty ku ajo ka qenë prej një kohe të gjatë, jo vetëm që ndryshon karakterin origjinal të zonës, por mund të shkaktojë edhe dëme afatgjatë në muraturë.

- Në disa raste të tjera, suvaja mbulon elemente guri me vlera dekorative (bazorelieve).

- Llaçi i çimentos përdoret shpesh në vend të llaçit të gëlqeres, që dëmton



a. Një mur i suvatur me një shtresë të trashë suvaje në Dhërm. Nuk këshillohet veshja e bazamentit me pllaka guri për mbrojtje nga lagështia.

b. Një banesë në Himarë fshat. Në foto duket qartë kontrasti mes punimit të kujdesshëm të punimit të gurit dhe suvatimit të muraturës në krahasim me murin e oborrit bashkëngjitur, i cili është më pak i mirëmbajtur. Përdorimi i teknikave të ndryshme për murin e banesës dhe murin rrethues të oborrit është i dukshëm në banesat e këtij rajoni.





c. Një tipologji murature në Himarë fshat. Për të mbajtur gurët në vend si dhe për të ruajtur muraturën nga dëmtimi, janë përdorur kapëse metalike.

d. Një tipologji banese në Vuno, me gurët e ekspozuar në qoshe.

e. Një mur i suvatur në Himarë fshat. Nuk inkurajohet që shtresa e suvasë të mbulojë gurët, prandaj kjo teknikë suvatimi nuk rekomandohet.

jo vetëm pamjen estetike të murit, por edhe muraturën.

- Izolimi i jashtëm mund t'i dëmtojë ndërtesat historike. Ai ndryshon karakteristikat dhe aktivitetin natyral të mureve origjinale prej guri, si edhe dëmton pamjen historike të ndërtesës dhe të gjithë ansamblit të fshatit.

Rekomandime

- Mirëmbajtja është faktori më i rëndësishëm në ruajtjen e banesave historike. Është e rëndësishme të mos lejoni që dëmet e vogla të zmadhohen aq sa të ndikojnë në materialet tradicionale.

- Rekomandohet mirëmbajtja dhe restaurimi, sa më shumë të jetë e mundur, i gjithçkaje origjinale. Duhet të shmanget rindërtimi i hapësirave të mëdha kudo që është e mundur. Këshillohet të përdoren teknika të përforsimit të përkohshëm aty ku nuk janë të mundura riparimet e menjëhershme. Në rastin kur muret janë të dëmtuara rëndë, mund të përdoren tiranta metalike për të mbajtur në vend gurët. Nuk këshillohet zëvendësimi i gurëve të pa dëmtuar.

- Inspektoni rregullisht muraturën e gurit (p.sh. çdo vit) për myshk, lirim gurësh dhe parandaloni ri ngritjen e tyre, duke kryer mirëmbajtjen e duhur.

- Çatitë duhen inspektuar në intervale të rregullta kohore; duhen riparuar menjëherë çarjet e vogla, për të mbrojtur çatinë si dhe muret poshtë saj.

- Dëmtimi i mureve, në sipërfaqe, në bashkime ose kudo tjetër duhet meremetuar me të njëjtat materiale të përdorura për ndërtimin e tyre: suva gëlqereje, gur natyral dhe dru.

- Suvaja me gëlqere është materiali tipik për suvatimin e mureve prej guri të ndërtesave tradicionale.

- Fugat e llaçit duhet të bëhen me kujdes që të mos mbulojnë gurët. Llaçi duhet të jetë sa më pak i dukshëm që të jetë e mundur.





3.3 Muret

- Për lyerje, bojërat me bazë gëlqereje gjenden lehtësisht dhe përshtaten shumë mirë me gurin dhe llaçin e gëlqeres. Boja me gëlqere mund të aplikohet çdo një ose dy vjet, pa shkaktuar probleme në muraturë.

- Banorët të cilët kanë udhëtuar apo punuar jashtë vendit shpesh kopjojnë ose "importojnë" metoda dhe elemente ndërtimi, të cilat nuk janë tradicionale për fshatrat e bregdetit jugor të Shqipërisë, si p.sh ballkonet e mëdha apo muret me suva të trashë.

- Ornamentet në gur, të cilat janë një tipar karakteristik i këtyre fshatrave dhe pjesë e rëndësishme e mureve të jashtme, duhet të trajtohen me kujdes dhe me njohuritë e nevojshme. Heqja e shtresave të vjetra të llaçit dhe bojës ndihmon në ruajtjen e gurit. Në të njëjtën mënyrë, myshku dhe algat e formuara në mure duhet të pastrohen, por nuk rekomandohet trajtimi me solucione kimike. I gjithë ky proces duhet bërë me dorë, me shumë kujdes. Nuk duhet synuar patjetër krijimi i një sipërfaqeje të përsosur që të duket si e re.

- Nëse shtëpia juaj është monument kulture, çdo ndërhyrje që bëni në strukturën e murit duhet të mbështetet me dëshmi fotografike si para edhe pas ndërhyrjeve.

- Këshillohet të ndiqet formula e saktë për përgatitjen e gëlqeres. Raporti është: një njësi agregatesh (rërë), një njësi ujë dhe një njësi gëlqere. Gëlqerja duhet të jetë nxehur në temperaturën e duhur, në mënyrë që të arrihet reaksioni i duhur për të garantuar fortësinë e lidhjes dhe të durojë temperaturat ekstreme të ngrirjes dhe shkrirjes.



a. Pamja nga afër e një murature dhe e kornizës së murit në Himarë fshat. Lyerja me gëlqere të bardhë në anën e djathtë të murit është teknika e këshilluar për t'u përdorur, ndërsa suvatimi i trashë në anën e majtë nuk rekomandohet.

b. Foto e detajit të një muri në Himarë fshat. Elementet dekorative si p.sh. gdhendjet në formë spiralesh në gur hasen në shumë raste në këto fshatra. Dekorime të ngjashme gjenden shpeshherë të mbuluara nga shtresa e trashë e suvasë.

c. Një cep i fasadës së një banese (monument kulture, kategoria I) në Dhërm. Gurë të gdhendur me ornamente që ngjajnë me fytyra njerëzish, janë të vendosur në fasadën e përparme. Elemente të tilla (nëse janë origjinale) duhet të ruhen dhe mirëmbahen.



VINI RE!

- **NUK rekomandohet përdorimi i suvasë me bazë çimentoje në muraturë për shkak se e dëmton atë. Këshillohet përdorimi i suvasë së gëlqeres.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i llaçit me çimento në muraturë, pasi shkakton lagështi dhe probleme të tjera të gurët. Përdorimi i llaçit më gëlqere është më i përshtatshëm.**
- **NUK rekomandohet mbulimi me suva i kornizave të dritareve apo dyerve.**
- **NUK rekomandohet mbulimi me suva i qosheve të mureve.**
- **NUK rekomandohet veshja me pllaka guri e mureve të reja që mund të keni ndërtuar prej betoni, sepse nuk përshtatet me karakteristikat tradicionale të banesave të fshatit.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i gurëve, veç atyre gëlqerorë, me ngjyrë bezhë ose gri të hapur.**

d. Një detaj i gdhendur me motive floreale në një banesë në Lukovë. Elemente të tilla, nuk duhen mbuluar me suva apo me materiale të tjera, pasi ato i shtojnë vlerë pamjes së përgjithshme të banesës dhe vetë fshatrave.

e. Një banesë e rikonstruktuar në Himarë fshat, me mure betoni të veshura me pllaka guri. Po ashtu, banesës i është bërë një shtesë me strukturë beton-arme. Nuk këshillohet përdorimi i teknikave dhe materialeve të tilla.





3.4 Portat dhe dyert




a. Një portë druri në fshatin Qeparo.

b. Portë hyrëse në Dhërmi. Lartësia e portës arrin tre metra dhe korniza është e stilit dorik.

c. Gur kyçi i një porte në Palasë, me vitin e ndërtimit të banesës të gdhendur sipër saj: 1888.

d. Një shul metalik porte në Ilias, që kalon në të dyja kanatat e portës.

e. Një portë hyrëse me qemer në Nivicë, me kamare për qirin apo kandil dhe me sofate në pjesët anësore të muraturës.



Portat dhe dyert e oborreve dhe shtëpive janë elemente të rëndësishme të tyre, që iu japin karakter banesave tradicionale. Nëpërmjet portave bëhet takimi i parë me banesën. Një portë e madhe dhe e rafinuar të jep të kuptosh se banesa është pronë e një familjeje të pasur dhe me autoritet në fshat.

Portat

Gjerësia e dyerve varion mes 150–200cm. Ato janë me dy kanata. Portat në këto zona janë bërë tradicionalisht prej druri dhe të zbukuruara me ornamente. Në disa raste, ato janë të përbëra prej një kornize druri dhe me dërrasa të përpunuara. Tradicionalisht nuk kanë qenë lyer. Në periudha të mëvonshme, veçanërisht gjatë asaj socialiste dhe pas vitit 1990, banorët filluan t'i lyejnë portat e shtëpive me ngjyra të ndryshme, blu, të gjelbër dhe gurkali. Në rastet kur druri i përdorur për ndërtimin e portave ishte i shtrenjtë dhe cilësor, portat nuk lyheshin. Fillimisht, ato vajoseshin, më pas filloi të përdorej metoda e llakosjes.

Gjatë periudhës socialiste shumë porta prej druri u zëvendësuan me panele metalike (edhe prej llamarine) të lyera me ngjyra të ndryshme (mbizotëronte ngjyra e gjelbër, gurkali dhe blu). Këto fletë metalike janë shpesh të ornamentuara me motive floreale ose gjeometrike. Ato kanë gjithashtu çakaçuke (çoku i derës) të veçanta (shpesh është një element që ngjan me dorë gruaje) gjë e cila i shton vlera akoma më shumë karakterit të këtyre elementeve.

Portat hyrëse janë zakonisht të vendosura në qemer prej guri. Thembra e qemerit, (guri i fundit i harkut) dhe guri i kyçit janë shpesh të theksuar duke i bërë më të mëdhenj dhe më të nxjerrë përpara. Qemeri shpesh herë përmban edhe dekorime. Njësoj si dekorimet e mureve, këto mund të jenë me motive floreale, gjeometrike dhe simbole fetare. Guri i kyçit (i qemerit) është në shumicën e rasteve më i përpunuar. Shpesh, aty vendoset viti i ndërtimit të portës (apo banesës) në bazoreliev. Në të dyja anët e qemerit, në disa raste





3.4 Portat dhe dyert

janë të vendosura kamare të vogla, të cilat përdoren për të mbajtur qirin apo ndriqes të vegjël. Sigurimi i portës bëhet nga brenda kryesisht nëpërmjet dy shufrave prej hekuri, që mbërthejnë secilën prej fletëve, nëpërmjet një grepi metalik. Nuk mungojnë edhe raste kur përdoret shuli i portës, që kalon tejprtej të dy fletëve dhe futet në të dy muret anësore.

Dyert

Dyert e banesës mund të kenë qemer ose arkitra drejtkëndor. Ato variojnë mes 90-100cm gjerësi dhe 210-230cm lartësi. Në disa raste kanë dhe kornizë guri, me përmasë rreth 15-20cm gjerësi. Tradicionalisht, dyert e banesave janë të ndërtuara prej druri pishe dhe shpesh kanë pasur strehë druri. Dyert janë gjithmonë një flegërshe dhe rrallë zbukurohen me motive të thjeshta. Sigurimi i dyerve bëhet me anë të një shuli në formë binari. Që prej 1990-s, disa prej dyerve tradicionale prej druri janë zëvendësuar me dyer alumini ose plastike. Ndërtesat që dalin drejt e në rrugë kanë vetëm një portë hyrëse, e cila mund të jetë me qemer, por edhe me arkitra drejtkëndor.

Mirëmbajtja

Sfida

- Dyert dhe portat prej druri apo metalike mund të përkeqësohen për shkak të mungesës së mirëmbajtjes apo përkujdesjes së gabuar. Shpesh, përgjatë viteve, dyert dhe portat vishen me disa shtresa boje dhe riparohen në mënyrë diletante. Si rezultat, funksionimi i dyerve dhe portave dëmtohet; ato nuk mbyllen siç duhet, pjesët metalike thyhen etj.

- Një problem i veçantë është mungesa e mbrojtjes së efektshme ndaj lagështisë. Shtresat e shumta të bojës, të mbivendosura, nuk lejojnë largimin e lagështisë. Ndonjëherë, kornizat e dyerve mbulohen me suva, gjë që krijon myk.





a. Një portë oborri me qemer, e mbyllur me gurë në fshatin Vuno.

b. Një derë prej druri në lias. Në kornizën e gurit janë të dukshme disa shtresa boje si dhe shenja lagështie. Shenja të dukshme përkeqësimi dallohen qartë edhe në kanatat e drurit të portës.

c. Vizatime (prerje dhe pamje ballore) të strehëve tradicionale të portave, të bëra prej druri dhe tjegulla argjile.

d. Një strehë porte tradicionale në Nivicë.





e. Një portë druri në fshatin Vuno. Pjesa e poshtme e saj është e dëmtuar dhe ka nevojë për mirëmbajtje.

f. Një derë e riparuar druri në Gjirokastrë. Pjesa e poshtme e derës ishte dëmtuar dhe kërkonte ndërhyrje. Elementet e kalbura janë prerë dhe janë vendosur elemente të reja (të dallueshme në ngjyrë). Foto e CHwB.

g. Një portë e riparuar së fundmi në qytetin e Beratit. Portës i janë shtuar elementet e reja prej druri (të dallueshme në ngjyrë), ndërsa struktura e strehës është rindërtuar tërësisht.

- Përdorimi i llaçit të çimentos për të bashkuar gurët e qemerit është një tjetër problem. Në shumicën e rasteve, punimet nuk zhvillohen me kujdes dhe llaçi përhapet në sipërfaqen e gurit. Tradicionalisht, llaçi nuk përdorej për bashkimin e gurëve.

Rekomandime

- Masa të vogla, por të zbatuara në mënyrë të rregullt (p.sh. çdo vit) ndihmojnë për të mbajtur dyert dhe portat në një gjendje të mirë gjatë viteve. Lyejini pjesët metalike me vaj, mbajeni drurin e pastër dhe të lyer me vaj lini, sigurohuni që elementet e gurëve rrethues nuk janë dëmtuar dhe bëni riparime të vogla herë pas herë për të shmangur humbjen e funksionalitetit. Materiale të ndryshme kërkojnë dhe lloje të ndryshme mirëmbajtjeje. Për të mirëmbajtur dyert e drurit duhet t'i lyeni apo të aplikoni shtresë me vaj lini; për dyert metalike mjafton të llakosen me vernik.

- Nëse vendosni të lyeni derën apo portën tuaj duhet të zgjidhni bojë që ka në përbërje vaj lini dhe nëse kjo është e vështirë për t'u gjetur, boja e zgjedhur duhet të shpërhapet dhe të jetë sa duhet elastike. Duhet përdorur tretës të rinj, që kanë përbërës shtesë si p.sh. dyllë, trajtues kundër mykut, kundër parazitëve etj.

- Përpara aplikimit të shtresave të reja, hiqini të gjitha shtresat e vjetra të saj. Në rast se pjesa e poshtme e portës është shumë e dëmtuar, kjo pjesë mund të vishet me fletë metalike (e ngjitur me gozhdë).

- Çfarëdolloj llaçi që mund të përdoret në muraturën e kornizës së dyerve apo portave, duhet të ketë si bazë përbërje gëlqereje dhe duhet aplikuar me kujdes që të mos shpërhapet në sipërfaqen e gurit.



3.4 Portat dhe dyert

Rinovimi ose zëvendësimi

Sfida

- Përkeqësimi i dymve dhe portave, shpesh rezultat i mungesës së mirëmbajtjes ose kujdesit jo të mirë, i detyron ndonjëherë banorët t'i ndryshojnë ose t'i zëvendësojnë tërësisht ato. Shpesh, dym të vjetra shumë të çmuara prej druri, të ndërtuara me materiale të cilësisë së lartë zëvendësohen me materiale surrogate, të lira dhe të një cilësie të ulët (zakonisht metalike ose plastike).

- Vlera e kornizave origjinale, të qemerit apo pjesëve të ndryshme të ornamenteve shpesh nënvlerësohet dhe ato hidhen.

- Materiali i drurit i përdorur për dym të reja shpesh nuk është i mirë staxhionuar ose nuk ka përqindjen e duhur të lagështisë e për pasojë përkeqësohet lehtë.

- Tradicionalisht, streha, e cila e mbron portën dhe qemerin nga kushtet klimatike dhe krijon mbrojtje për njerëzit kur hyjnë në banesë, ndërtohet si struktura e çatisë. Këto elemente shpesh hiqen ose rindërtohen me materiale jo të përshtatshme (p.sh. fletë metalike ose plastike). Kjo gjë dëmton imazhin tradicional të fshatit.

Rekomandime

- Dymt apo portat historike si dhe qemerët e portave duhen mbrojtur ose rindërtuar. Vlera e një dym apo porte origjinale prej druri është shumë më e madhe sesa vlera e çfarëdolloj zëvendësimi modern. Në shumicën e rasteve ato kanë nevojë vetëm për një riparim të pjesshëm për të punuar sërish.

- Përpikuni të ruani dhe konservoni, sa herë është e mundur, të gjitha pjesët përbërëse të portave e dymve: qemerët e vjetër, pjesët metalike, elementet dekorative etj. Kur kryeni punime mirëmbajtjeje apo rinovuese, më e mira



a. Një dym i ruajtur mirë i një banese në Dhërmi. Të gjitha elementet e banesës kanë vlera të rëndësishme dhe si të tilla, duhen mirëmbajtur.

b. Një portë në fshatin Lukovë. Dekorimet me bazoreliev me motive floreale kornizojnë murin e portës, teksa edhe vetë porta ka disa dekorime që i shtojnë vlera.

c. Një derë e përbërë prej dërrasash të thjeshta horizontale në një banesë në Vuno. Elementet prej druri mund të ruhen duke përdorur bojëra me material izolues, por jo me ngjyra të ndezura.

d. Vizatimi i një porte druri tipike e vendosur në qemer.

e. Vizatim i një dym tipike prej druri.



b.



c.



d.

Guri i kryçit

Qemer guri

Listelë druri e kapur me gozhdë

Dorezë

Kasë dere

Prag guri



e.

Arkitra drejtkendor

Trokitëse dere

Dorezë metalike

Derë druri

Prag guri



3.4 Portat dhe dyert

është të rrvihen në përdorim pjesët e vjetra origjinale (p.sh një rast mund të jetë ripërdorimi i çokut të derës). Kurdoherë që është e mundur, përdorni materiale të ngjashme (p.sh. zëvendësojini pjesët e dëmtuara të derës me dru të të njëjtit lloj) si dhe zëvendësoni menteshat e thyera, vidhat apo gozhdët, me pjesë të ngjashme me origjinalin. Kur është e nevojshme, rekomandohet çmontimi i derës apo portës, kryerja e riparimeve të nevojshme dhe montimi i pjesëve sërish. Kur riparoni një derë apo portë dhe dëshironi ta lyeni me bojë, zgjidhni ngjyra që i përshtaten karakterit historik të dymve të fshatit (shih paletën e ngjyrave).

- Druri mund të riciklohet. Mund ta ripërdorni materialin e drurit të një dere, porte a dritareje tjetër, që nuk ju hyn më në punë(duke e ritrajtuar dhe përpunuar atë).

- Pozicioni i portave në fshat është i rëndësishëm. Nëse porta ndodhet në rrugët kryesore dhe ajo duhet ndërruar, rikonstruksioni duhet bërë me dru, ndërsa në se ato nuk ndodhen në rrugë kryesore, mund të përdoren dhe fletët metalike.

- Në përgjithësi, dyert dhe portat prej druri nuk duhen ndryshuar, por duhen mirëmbajtur sa më shumë të jetë e mundur Zëvendësimet duhen përdorur vetëm kur riparimi apo rinovimi nuk është i mundur. Në këto raste, riprodhimi duhet të përputhet me origjinalin për sa i përket madhësisë, përpjesëtimeve dhe materialit. Nëse objekti origjinal nuk ekziston dhe nuk ka dokumente të gjendjes historike, dera apo porta e re duhet të ruajë pamjen e përgjithshme, konstruksionin, përpjesëtimet dhe materialet e asaj ekzistuese, por edhe të portave të tjera të ngjashme në fshat.

- Historikisht, dyert dhe portat ndërtoheshin duke përdorur dru pishe. Nëse dyert apo portat prej druri duhen zëvendësuar, rekomandohet druri i pishës, i cili jo vetëm përputhet me traditën, por është shumë cilësor dhe gjendet lehtësisht (përqindja e lagështisë duhet të jetë 12-18%).

- Megjithatë, mund të përdoren edhe lloje druri të tjera: dru arre, paleta druri,



a. Një portë metalike në fshatin Dhërmi. Elementet dekorative të përdorura në këtë shembull, i shtojnë vlerë karakterit të fasadës së banesës si dhe vetë fshatit.

b. Një derë prej druri në Vuno. Dërrasat e përdorura për pjesën e sipërme të derës janë në kushte të mira, por pjesa e poshtme ka filluar të dëmtohet nga ndikimi i reshjeve dhe diellit.

c. Një portë metalike në Lukovë. Problemet e lagështisë janë të dukshme në kornizën e gurit.





d.

d. Kapëse metalike të përdorura për të mbajtur në vend gurët, në kornizën e një porte në Lukovë.

e. Një rikonstruksion i kohëve të fundit i kryer në Himarë. Për krijimin e hapjeve të reja në arkitra dhe soletë është përdorur beton-arme. Nuk rekomandohet përdorimi i këtyre teknikave, sepse nuk janë tradicionale dhe nuk përshtaten me materialet tipike të rajonit.

f. Foto e një porte oborri e mbyllur me gurë. Nuk rekomandohet mbyllja e hapjeve ekzistuese.

g. Një derë e re prej druri në fshatin e Himarës, me materiale dhe formë tradicionale.

dru pishe importi ose paleta druri të parafabrikuara.

- Një tjetër mënyrë për të rinovuar portat apo dyert e dëmtuara mund të jetë duke i mbuluar ato pjesërisht apo tërësisht (në rast degradimi të rëndë) me fletë metalike. Këto fletë vendosen mbi dru duke i ngjitur me gozhdë apo bulona.

- Gjithsesi, nëse një portë apo derë origjinale nuk mund të riparohet dhe zëvendësimi i saj me një derë të re prej druri, për momentin nuk është i mundur, mund të bëhet zëvendësimi i saj me një portë prej flete metalike. Është gjithashtu e mundur që këto dyer të dekorohen me motive të ndryshme, duke i risjellë në një mënyrë tjetër motivet origjinale të tyre.

- Strehët e portave duhen ndërtuar me materiale tradicionale: strukturë druri dhe tjegulla.

Bërja e hapjeve të reja apo mbyllja e atyre ekzistuese

Kur pronarët duan të bëjnë ndryshime funksionale në banesat e tyre, shpesh vendosin të ndryshojnë formën dhe madhësinë e hapjeve ekzistuese ose të bëjnë hapje të reja për t'ia përshtatur dverve të reja të gatshme që kanë blerë.

Sfida

- Ndryshimi apo bërja e hapjeve të reja për dyer, mund të shkaktojë probleme strukturore në banesë. Mbushja e hapjeve të reja me materiale jo të përshtatshme mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në qarkullimin natyror të ajrit dhe lagështinë e banesës, duke shtuar kondensimin dhe krijuar myk.

- Hapjet e reja mund të çojnë në krijimin e problemeve strukturore dhe të ndikojnë në qëndrueshmërinë e përgjithshme të banesës.



e.










f.



g.



3.4 Portat dhe dyert



VINI RE!

- **NUK rekomandohet heqja e dymve apo portave tradicionale.** Zëvendësimet duhen bërë vetëm kur riparimi apo rinovimi nuk është i mundur. Në këto raste, riprodhimi duhet të jetë i ngjashëm me origjinalin për sa i përket madhësisë, përpjesëtimeve dhe materialeve.
- **NUK rekomandohet zëvendësimi i dymve apo portave origjinale, me përjashtim të rasteve kur rinovimi nuk është i mundur.**
- **NUK rekomandohet ndryshimi i pozicionit dhe i përpjesëtimeve të dymve në fasadat e banesave tradicionale.**
- **NUK lejohet ndryshimi i përpjesëtimeve dhe madhësisë së dymve apo portave tradicionale në rastet e banesave që janë monument kulture ose që ndodhen në qendra historike.** Çdo ndërhyrje duhet të mbështetet me dëshmi fotografike para dhe pas saj dhe duhet miratuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

- Hapjet e reja për dym, në disa raste janë shumë të mëdha dhe nuk përshtaten me përmasat e hapjeve tradicionale.

Rekomandime

- Kur bëni punime rinovuese ose transformoni hapësirat për të siguruar sipërfaqe për funksione të reja, është e rëndësishme që këto ndërhyrje të bëhen duke pasur parasysh karakterin e përgjithshëm të banesës historike.

- Dymet duhet të jenë në harmoni me hapjet e tjera në fasadë. Kur patjetër është e nevojshme mbushja e hapjeve ekzistuese, këtë gjë duhet ta bëni me materiale të ngjashme me karakteristikat e gurëve ekzistues (ngjyrë, madhësi dhe përmasa).

- Nëse e konsideroni patjetër të nevojshme, të bëni hapje të reja për dym në fasadë, duhet të konsultoheni me institucionin përkatës (DRKK Vlorë ose Bashkia Himarë).

a. Tipa dhe ngjyra të ndryshme dymesh e portash në fshatrat e rajonit të Himarës.

b. Një portë në Lukovë. Fletët e drurit të dekoruara janë të mirëmbajtura, por korniza prej betoni e portës e lye me të kuqe të ndezur, nuk është një shembull i mirë për t'u ndjekur.

c. Një derë e re në fshatin e Himarës. Nuk rekomandohet përdorimi i materialeve të tjera përveç drurit, prandaj nuk këshillohet zëvendësimi i dymve me të tilla lloje moderne.



b.



c.



3.5 Dritaret



a. Dritare me qemer guri në fshatin Qeparo, me kanata druri të ruajtura mirë.

b. Një dritare e katit të parë të një banese në Dhërmi, tipike për këtë rajon, me dy kanata druri, secila prej tyre e ndarë në tre panele xhami.

c. Dritare të katit të parë të një banese në fshatin Vuno. Kapakët tradicionale prej druri të fiksuar në kornizën prej guri janë të ruajtur mirë.

Dritaret në banesat e fshatrave të bregdetit mund të kenë qemer (me hark) ose mund të jenë me arkitra drejtkëndor. Në përgjithësi, dritaret me qemer janë më të vjetra në kohë dhe më pas janë zëvendësuar nga dritare me arkitra të drejtë. Madhësitë dhe përpjesëtimet e dritareve nuk ndryshojnë shumë, lartësitë janë zakonisht 1.5 deri në 2 herë më shumë se gjerësia. Dritaret janë të përbëra prej dy kanatave simetrike, secila prej tyre e ndarë në tri panele xhami. Madhësitë e tyre variojnë ndërmjet 80-100cm në gjerësi dhe 120-150cm në lartësi.

Dritaret e banesave janë më të mëdha në katin e parë krahasuar me atë përdhës, në rastin e *banesës me kat* dhe janë të njëjta në të dyja katet, në rastin e *banesës së Bregut*.

Materialet

Kornizat e dritareve janë prej druri. Historikisht, nuk është përdorur xhami. Dritaret mbylleshin me kapakë po prej druri (baxhuke). Rreth fundit të shek. XIX, filloi të vihej në përdorim xhami, duke përmirësuar mbrojtjen ndaj kushteve klimatike.

Kapakët

Kapakët tradicionale të dritareve janë të ndërtuar me dërrasa të thjeshta të fiksuar në kornizën e dritares ose në fasadë. Kapakët kanë si funksion estetik ashtu edhe mbrojtës.

Kornizat e dritareve

Kornizat e dekoruara të dritareve janë elemente tipike të fasadave të banesave të këtyre fshatrave. Muratura e kornizave është e përpunuar me kujdes dhe shpesh e zbukuruar me ornamente gdhendur në gur, të cilat mund të kenë vitin e ndërtimit të ndërtesës ose janë bazorelieve me vlera të larta estetike.

Një tjetër tip hapjeje është hapja e vogël, e njohur si *frëngji*, e cila ka formë





3.5 Dritaret

pyke, me majën nga faqja e jashtme e muraturës. Frëngjitë janë përdorur për qëllime mbrojtëse. Të tilla mund të ketë si në katin përdhes, ashtu edhe në katin e sipërm. Në fshatrat e hershme, kur banorët ndryshonin përdorimin e hapësirave të brendshme, i mbushnin hapjet me gurë dhe krijonin hapje të reja më të mëdha për dyer dhe dritare.

Rinovimi i dritareve

Sfida

- Si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes, dritaret e vjetra prej druri e humbasin funksionin e tyre. Ato nuk mbyllen mirë dhe nuk sigurojnë mbrojtjen e duhur ndaj kushteve klimatike. Kjo gjë vihet re edhe te kanatat e dritareve. Të vjetruara e të ngrëna nga koha dhe kushtet e motit, ato nuk i mbrojnë si duhet hapësirat e brendshme. Si pasojë, disa banorë i zëvendësojnë dritaret dhe kanatat e vjetra prej druri me materiale moderne dhe jo tradicionale, të cilat janë shpesh të një cilësie jo të mirë si p.sh ato prej plastike. Kjo ndikon negativisht në mikroklimën e krijuar brenda ndërtesës dhe mund të shkaktojë lagështi dhe myk në muret e ndërtesës.

- Ngjyrat e përdorura për dyert dhe kanatat shpesh janë shumë të forta, duke dëmtuar peizazhin tradicional të fshatrave.

- Nuk janë vetëm ndikimet e kohës që çojnë në dëmtimin e dritareve. Rinovimet e bëra në mënyrë të papërshtatshme, si p.sh. veshja me suva e kornizave të hapjeve të dritareve apo dyerve mund të përshpejtojë dëmtimin e elementeve tradicionale të ndërtesës.

Rekomandime

- Nuk rekomandohet zëvendësimi i dritareve apo kanatave të dritareve prej druri me materiale të reja, nëse ato nuk janë të dëmtuara. Në shumicën e rasteve ekzistojnë mundësitë për riparimin e dritareve ekzistuese. Edhe dritaret tradicionale prej druri mund të plotësojnë më së miri kërkesat



a. Dritare me material plastik në fasadën e një banese në Qeparo fshat. Plastika apo duralumini nuk janë materiale që këshillohen për t'u përdorur për dritaret. Për më tepër, duket qartë se përmasat e dritares në katin përdhes janë ndryshuar, gjë e cila nuk duhet inkurajuar.


b. Foto e një dritareje të rinovuar së fundmi në një banesë në Himarë fshat. Korniza është bërë me dru të trajtuar dhe është lyer me ngjyrë rozë të hapur, të cilat i shtojnë vlerë fasadës në përgjithësi. Kapakët prej druri janë në formën tradicionale, duke sjellë një shembull të mirë.

c. Kanatet e mbyllura të një dritareje tjetër të së njëjtës banesë në Himarë Fshat.

d. Vizatim i një dritareje tipike me qemer.

e. Tre shembuj të detajeve tradicionale të kapakëve dhe dritareve.







3.5 Dritaret

bashkëkohore për komfort dhe eficiencë energjetike. Në rast se korniza e dritares e lejon, mund të vendosni xham të dyfishtë ose xham më të trashë.

- Kanatat e dritareve (ose baxhukët) janë elemente të rëndësishme tradicionale, të cilat duhet të mirëmbahen sa më shumë të jetë e mundur. Ato funksionojnë si mbrojtëse të dritareve ndaj kushteve klimaterike. Kanatat e reja duhen bërë prej druri dhe në rast përdorimi të bojës, rekomandohet të zgjidhni ngjyra të përshtatshme me karakterin e fshatit.

- Gjatë rinovimeve, pjesët e dëmtuara mund të priten me kujdes dhe të zëvendësohen me të njëjtin lloj druri dhe të bashkohen me ngjitës natyral.

- Druri duhet lyer me vaj dhe llakosur rregullisht (çdo vit) duke përdorur vaj lini dhe trajtime me solucione kundër parazitëve ose që kanë përbërje dylli, sepse ndihmojnë në mirëmbajtjen e drurit.

- Mund të ripërdorni menteshat, vidhat, çernieret, dorezat apo elementet e tjera të dritareve ose mund t'i zëvendësoni ato me pjesë origjinale apo të ngjashme me to. Po ashtu, është e mundur të ripërdoret xhami origjinal, që në shumicën e rasteve është i padëmtuar dhe mund të vazhdojë të kryejë funksionin për vite të tjera me radhë.

- Nëse boja është dëmtuar, kjo nuk do të thotë se edhe druri është dëmtuar. Përpara rilyerjes, rekomandohet heqja e të gjithë shtresave ekzistuese të bojës. Bojërat e përdorura për dritaret tradicionale duhet të kenë përbërje me bazë vaji.

- Është tepër e rëndësishme të lyhen të gjitha pjesët metalike dhe lyerja të bëhet çdo vit. Rekomandohet përdorimi i elementeve izoluese prej gome dhe këshillohet vendosja e elementit mbrojtës (davançalit) në dritare, të cilët po ashtu duhen mirëmbajtur.

- Kur vendosni për llojet e ngjyrave, zgjidhni ngjyrën origjinale të drurit. Në rast përdorimi ngjyrash të tjera, duhet të zgjidhni ndërmjet ngjyrave që janë të përshtatshme për rajonin.



a. Dritare e re në një banesë në Dhërmi, që ka ndjekur formën dhe materialet tradicionale. Kornizat prej druri janë të përbëra prej katër panelesh xhami.

b. Një dritare në Vuno me një strehë si çati. Nuk sugjerohet përdorimi i strehëve për dritaret.

c. Dritare e një banese dykatëshe në Dhërmi. Kapakët prej druri janë të ruajtur mirë dhe në formë tradicionale. Nuk rekomandohet përdorimi i ngjyrave të ndezura dhe fluoeshente.

d. Vizatim i një dritareje me qemer harkor dhe pa kapakë. Ajo përmban *anëcarkë* në pjesën e poshtme, ku mund të vendosen vazo me lule.

e. Vizatim i një dritareje tipike të rajonit.





Hark guri

Arkitra drejtkëndor guri

Panel xhami

Kasë druri

Parvaz guri

d.



Menteshë metalike (çernierë)
e fiksuar në gur

Kapak druri

Arkitra drejtkëndor guri

Panel xhami

Kasë druri

Parvaz guri

e.



3.5 Dritaret

- Nuk duhet bërë veshja me suva e kornizave të dritareve. Në të kundërt, ato duhen kontrolluar dhe pastruar në mënyrë periodike.
- Duhet të kërkoni të gjitha mundësitë për të gjetur dru të cilësisë më të mirë. Një mundësi e mirë është ripërdorimi i drurit të vjetër, që është përdorur më parë për dyer apo dritare të tjera, tuajat apo të fqinjëve.
- Nuk duhen vendosur strehë në dritare. Rekomandohet përdorimi i kanatave të brendshme ose të jashtme për mbrojtje.
- Përgjithësisht, kanatat duhet të jenë pa shtresa të njëpasnjëshme, siç kanë qenë në fillim. Në rast se vendosni të përdorni ngjyra, ju lutemi të zgjidhni ngjyra që janë në përputhje me pamjen e krejt fshatrave.
- Mos përdorni ngjyra shumë të forta dhe të shndritshme për kanatat apo dritaret e banesave në qendra historike.

Zëvendësimi i dritareve

Sfida

- Në dhjetëvjeçarët e fundit, gjatë rinovimit të ndërtesave, banorët shpesh i kanë ndërruar dritaret prej druri, me ato me materiale plastike ose alumini. Kjo gjë dëmton tërësinë e pamjes së ndërtesës dhe qëndrueshmërinë teknike të saj, përfshirë këtu edhe aftësinë e mureve prej guri për të qenë fleksibël dhe për t'i rezistuar ndryshimeve të temperaturës dhe lagështisë.
- Gjatë kryerjes së rinovimeve, banorët shpesh kanë mbyllur dritaret nga veriu që ka banesa, duke mos lejuar kështu ajrimin e duhur të saj. Kjo dëmton shpesh strukturën e shtëpisë për shkak të krijimit të mykut dhe lagështisë si dhe të temperaturave të larta gjatë muajve të verës.
- Në mënyrë të ngjashme, dëmtime ndodhin edhe kur bëhen hapje të reja për dritare në fasadë si dhe kur ndryshohen përmasat dhe përpjesëtimet e hapjeve ekzistuese. Veprime të tilla jo vetëm që dëmtojnë unitetin pamor të banesës, por edhe ndikojnë jashtëzakonisht shumë në strukturën dhe marrëdhënien e saj me mjedisin.



a.

a. Dritaret prej PVC-je (plastikë dhe duralumin), për shkak se kanë izolim të fortë, nuk lejojnë kalimin e ajrit. Për këtë arsye mund të shkaktojnë krijimin e mykut në pjesën e brendshme të murit.

b. Një dritare me kapakë plastikë në ngjyrë të gjelbër në Nivicë. Rekomandohet ruajtja e ngjyrës origjinale të drurit ose përdorimi i ngjyrave pastel, duke qenë se i përshtaten më shumë karakterit tradicional të këtyre fshatrave.

c. Një dritare në Kudhës, ku korniza prej druri është e ruajtur mirë, por panelet e xhamit nuk janë të vendosura në mënyrën e duhur ose mungojnë.

d. Pamja e brendshme e një dritareje prej plastike në Dhërmi.

e. Një dritare me kapakë plastike, që imitojnë drurin dhe me kornizë të veshur me pllaka guri. Nuk është një shembull që duhet rekomanduar për fshatrat e rajonit.



b.



c.



d.



e.

VINI RE!

- **NUK rekomandohet zëvendësimi i dritareve dhe të kapakëve të vjetër prej druri me alternativa moderne, të bëra prej materialeve jo tradicionale. Kjo gjë ndikon negativisht në mikroklimën brenda ndërtesës dhe mund të shkaktojë shumë lagështi dhe të krijojë myk në mure.**
- **NUK rekomandohet zëvendësimi i pjesëve origjinale të dritareve me elemente jo tradicionale.**
- **NUK rekomandohet zëvendësimi i dritareve historike dhe kanatave me kanate të reja, nëse ato nuk janë të dëmtuara rëndë. Në shumicën e rasteve, është e mundur të rinovohen kanatat apo dritaret ekzistuese.**
- **NUK rekomandohet shtimi i strehëve mbi dritare. Rekomandohet përdorimi i kanatave të jashtme dhe të brendshme për mbrojtjen e banesës**

Rekomandime

- Nëse dritaret ekzistuese nuk mund të riparohen dhe është e nevojshme vendosja e dritareve të reja, ato duhet të jenë prej druri dhe të ruajnë formën tradicionale. Duhet të siguroni dru të staxhionuar mirë dhe me lagështinë e duhur (jo më e lartë se 12-15%).

- Vendosja e dy dritareve, një për pjesën e brendshme dhe një për të jashtmen siguron mbrojtje shumë të mirë nga kushtet klimaterike, por është e rëndësishme të siguroni që së paku dritarja e jashtme të ngjajë me dritaret e mëparshme tradicionale.

- Dritaret dhe dyert nuk duhet të pengojnë qarkullimin e ajrit. Dritaret prej plastike ose metali pengojnë shkëmbimin e ajrit, sidomos kur janë të mbyllura për një kohë të gjatë. Nëse nuk kryhet qarkullimi i duhur i ajrit, muret pranë dritareve mund të krijojnë myk.

f. Dritare tradicionale e mirëmbajtur në një banesë në Dhërmi.

g. Kapakë të rinj të një dritareje banese në Dhërmi.

h. Një dritare e re në fshatin Vuno, me skelet dhe kapakë druri, me formë dhe përmasa të përshtatshme me dritaret tradicionale. Dritarja është e pajisur edhe me shufra hekuri për mbrojtje.

i. E njëjta dritare, e parë nga hapësirat e brendshme të banesës.





3.6 Ballkonet dhe verandat



a. Një ballkon tipik i fshatrave të Jugut, i rindërtuar gjatë periudhës së socializmit, me beton dhe hekur. Trarët e vegjël prej guri (*anëcark*) dëshmojnë se ballkoni është i hershëm.

b. Ballkonet tipike të këtij rajoni janë zakonisht të vogla, si këto në foto (në Dhërmil). Përdorimi i konstruksionit betonarme tregon se janë ndërtuar gjatë periudhës socialiste.

c. Një verandë ose *kamerie* e një banese në Kudhës. Veranda është ndërtuar mbi një platformë guri dhe strukturë qemerit, që të çon në katua në katin përdhes.

d. Një ballkon i një banese të tipologjisë së dytë (*banesa e Bregut*) në Dhërmil.

Ballkonet në fshatrat e rajonit bregdetar jugor të Shqipërisë janë zakonisht të vogla dhe të vendosura në qendër të fasadës kryesore në katin e sipërm. Ato shkojnë deri në një metër thellësi dhe dy metra gjerësi. Në shumicën e rasteve janë të orientuara me pamje nga deti. Zakonisht ballkonet e fasadave nuk lidhen me verandat, të cilat ndodhen në pjesët anësore të ndërtesës. Ballkonet historikisht kanë qenë ndërtuar prej druri. Për fat të keq, shumica e këtyre ballkoneve origjinale janë dëmtuar dhe më vonë janë zëvendësuar me ndërtime prej betoni të varfër dhe përforcues hekuri. Parmakët tradicionalë janë prej hekuri të përpunuar me ornamente.

Verandat janë më tipike për tipologjinë e parë të banesave (*banesa me kat ose me gjysmë kat*) (shih 3. Banesa faqe 31). Ato janë të vendosura në hyrjen e banesës dhe lidhen me shkallë me katin përdhes dhe më tej me hyrjen për në katin e parë të banesës. Tradicionalisht, kanë qenë të ndërtuara me gurë dhe të mbuluara me struktura druri. Shkallët që lidhin verandat me katin përdhes janë po ashtu të ndërtuara me gurë. Gjatë dhe pas periudhës socialiste, shumë prej tyre u zëvendësuan me struktura beton-armeje. Në ditët e sotme, ato janë shpesh të mbuluara me të njëjtën strukturë si çatia dhe hyrja bëhet nëpërmjet shkallëve prej betoni. Parmakët janë prej betoni ose metali.

Sfida

- Ballkonet janë konstruksione të jashtme, të ekspozuara ndaj faktorëve atmosferikë. Për këtë arsye, është e nevojshme gjetja e zgjidhjeve për drenazhimin e ujit të shiut, rezistencën ndaj dëmtimit prej ngricave të dimrit dhe lëvizjeve strukturore në kushtet e të ftohtit apo të nxehtit e jashtëzakonshëm. Mirëmbajtja e gabuar ose mungesa e saj dhe ndryshimet e bëra nga vetë banorët, mund të përkeqësojnë probleme si këto: mund të zhvillohen çarje, ku hyn uji duke krijuar çarje edhe më të mëdha, duke e ekspozuar strukturën ndaj problemeve afatgjatë me lagështinë, që mund të çojnë në prishjen strukturore dhe rënien e mundshme të ballkonit.





3.6 Ballkonet dhe verandat

- Dëmtimi nga kushtet atmosferike i izolimit në pjesën që lidh ballkonin me strukturën e ndërtesës fut lagështinë në ndërtesë, duke shkaktuar dëme të fshehura që ka shumë mundësi të jenë mjaft serioze.
- Banorët shpesh ndërtojnë ballkone të reja, që historikisht nuk kanë qenë aty, shumë të mëdha dhe që bllokojnë gjithë fasadën, duke shkaktuar edhe dëme strukturore. Ballkonet ekzistuese ose të reja pajisen me parapet muri në vend të parmakëve metalikë, duke rritur kështu peshën e strukturës së ballkonit, por edhe duke krijuar mospërputhje pamore.

Rekomandime

- Nëse ballkoni është në gjendje të keqe, është shumë e nevojshme të thirret një inxhinier për të inspektuar qëndrueshmërinë strukturore dhe sigurinë e tij. Çdo riparim i nevojshëm duhet të kryhet nga një kompani e specializuar.
- Nuk duhen ndërtuar ballkone të reja, nëse nuk ka dëshmi që ato kanë qenë aty më parë. Është e këshillueshme të mirëmbahen parmakët ekzistues metalikë. Çdo zëvendësim duhet të bëhet me struktura të lehta, njësoj si të ballkoneve të ekzistuese (p.sh. parmakët të jenë metalikë, struktura të jetë prej hekuri dhe me platformë druri).
- Nuk duhen shtuar parapete betoni ose guri në ballkonet ekzistuese.
- Bëni kontrolle të rregullta, çdo vit, për gjendjen e ballkoneve.
- Nuk duhet të ndërtohen ballkone shumë të mëdha që bllokojnë tërë fasadën, por të vogla dhe të ngjashme me ato tradicionale (në madhësi dhe përpjesëtime).
- Në rast se do të ndërtoni një ballkon të ri, është e rëndësishme të tregoni kujdes në nivelimin e duhur të strukturës, në mënyrë që uji të kullojë larg ndërtesës.





a. Ballkoni në foto është një shembull tipik, i vjetër dhe shumë i përpunuar. Struktura është prej hekuri, e mbuluar me shufra druri. Ky ballkon nuk është mirëmbajtur dhe është në gjendje të keqe.

b. Një shembull tipik i ballkoneve tradicionale, të cilat i janë shtuar përforcues hekuri për të mbajtur ngarkesën strukturore. Për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, elementet e hekurit, të cilat duhet të ishin lyer ose mbrojtur, janë ndryshkur.

c. Një ballkon betoni i cili nuk është mirëmbajtur, e për këtë arsye ka probleme strukturore duke rrezikuar të shembet dhe të përbëjë rrezik për këdo që qëndron në të apo kalon poshtë tij.

d. Vizatime të ballkoneve tipike të rajonit bregdetar jugor, me trarë konsol prej guri, platforma prej betoni dhe parmakë metalikë.






d.



3.6 Ballkonet dhe verandat



VINI RE!

- **NUK rekomandohet ndërtimi i ballkoneve nëse nuk ka dëshmi që kanë ekzistuar edhe më parë aty, veçanërisht në rastet e monumenteve të kulturës dhe qendrave historike.**
- **NUK rekomandohet ndërtimi ose zgjerimi i ballkoneve ekzistuese, të cilat janë shumë të mëdha dhe bllokojnë tërë fasadën e ndërtesës.**
- **NUK rekomandohet shtimi i parapeteve prej muri në ballkonet ekzistuese (këshillohet përdorimi i parmakëve metalikë).**

a. Kolazh fotografish të tipave të ndryshëm të ballkoneve dhe verandave të rajonit bregdetar të Himarës. Disa prej tyre janë më tradicionale se të tjerët si p.sh. në përdorimin e materialeve, por të gjithë këta shembuj përfaqësojnë karakterin dallues të kësaj zone.

b. Një banesë e rinovuar së fundmi në Dhërm. Ballkoni prej betoni dhe parmakët metalikë janë në gjendje të mirë dhe i kanë sjellë një vlerë të shtuar banesës dhe karakterit të fshatit.





3.7 Çatitë



a. Pamje ajrore e fshatit Qeparo. Autori: Joerg Daiber (Spoonfilm medienproduktion GmbH).

b. Pamje nga afër e një qosheje të një banese në Dhërmi, që tregon detajin e strehës së çatisë.

c. Konstruksion tipik i çatisë së një banese në Dhërmi. Çatia është e sapo ndërtuar me dru pishe të staxhionuar.

Çatitë përbëjnë një veçori që karakterizon peizazhin tradicional të ansamblit historik të këtyre vendbanimeve. Çdo vendim individual që merret për ndryshimin e çative ka ndikim të ndjeshëm në imazhin e përgjithshëm të fshatit. Banesat tradicionale në këto zona kanë çati me strukturë druri të mbuluar me tjegulla prej argjile. Tipologjitë kryesore të çative janë *dy ujëse* (me dy pjerrësi) dhe *katër ujëse* (me katër pjerrësi).

Pjerrësia e çatisë varion mes 20° deri 30°. Strehët janë një element tepër i rëndësishëm i tyre. Ato dalin përsipër murit me rreth 20cm. Për të mbyllur strehën, për mbrojtjen nga insektet dhe faktorët atmosferikë, përdoren dërrasa të fiksuara me gozhdë. Në raste të tjera, në pjesën e sipërme të murit, nën çati, ndërtohen korniza, kryesisht prej guri ose me tulla. Përveç rëndësisë që ka përzgjedhja e llojit të çatisë, një aspekt tjetër që ndikon në këtë strukturë është disponueshmërinë e drurit në seksione të medha dhe me cilësi të mira mekanike. Në këtë rajon, më shpesh hasen tipe çatish tradicionale më të përpunuara, në konstruksionin e të cilave baballëkët janë zëvendësuar me *pajanda* të shumta, të lidhura me *mahitë* dhe trarët. Në ndërtimet e reja, vihet re përdorimi më i shpeshtë i çatisë vetëm me *baballëk* dhe *pajanda* diagonale. Kur është e mundur, strukturat e çative ndërtohen me dru lisi, për shkak të fortësisë dhe përmasave të tij të mëdha. Kur kjo nuk është e mundur, përdoret druri i pishës, i qiparisit ose i bredhit. Lidhja e strukturës bëhej nëpërmjet gozhdëve prej hekuri, të bëra me dorë. Më vonë, janë përdorur edhe gozhdë industriale. Në përgjithësi, nuk është vënë re përdorimi i ulluqeve horizontale apo vertikale, por gjenden edhe raste përdorimi të tyre, të cilët mbledhin ujin e shiut, kryesisht në stera (shih 3.1 Oborret, faqe 37) për t'u përdorur për nevoja të ndryshme. Këto ulluqe janë prej druri në formë V-je ose për to janë përdorur tjegulla të kthyera mbrapsht.

Mbulesa e çatisë

Çatitë tradicionale nuk kanë papafingo ose thyerje të tjera, përveçse kur oxhakët ndodhen në pjesët anësore të çatisë. Tjegullat e çative janë prej



3.7 Çatitë

argjile të shtrua në stilin *kapak* dhe *ulluk* pa llaç lidhës. Ato janë zakonisht rreth 17-20 cm të gjera dhe 38-40 cm të gjata. Ngjyrat e tyre variojnë mes okrës, kafes ose kafes në të kuqe. Shumë banesa kanë tjegulla të reja të prodhuara në mënyrë industriale, të cilat nuk kanë të njëjtën formë apo lloje ngjyrash me ato tradicionale. Kjo sjell cënimin e imazhit tradicional të fshatit.

Mirëmbajtja

Sfida

- Pamundësia e hyrjes në strukturën e çatisë vështirëson mirëmbajtjen e tyre.
- Strukturat prej druri të çatisë dëmtohen lehtë nga lagështia dhe insektet.

Rekomandime

- Nuk duhen bërë hapje në çati, duke qenë se nuk janë veçori të banesave tradicionale të zonës. Inspektimi i çatisë është i rëndësishëm dhe duhet të bëhet në mënyrë të rregullt. Nëse ka nevojë, dalja për në çati dhe mirëmbajtja e tjegullave mund të bëhet me shkallë nga jashtë, por për pjesën e brendshme nevojitet një zgjidhje tjetër si p.sh. një derë të brendshme në tavan.
- Çatia duhet të kontrollohet dhe të mbrohet me lëndë kundër parazitëve.
- Tjegullat e vjetra të çative mund të thyhen, të bien apo të lëvizin nga vendi. Për këtë arsye, duhen kontrolluar çdo vit. Nëse ka tjegulla që kanë lëvizur apo janë liruar, duhet t'i rivendosni ose t'i zëvendësoni me të tjera të ngjashme.
- Gjithashtu, tjegullat e vjetra mund t'i ripërdorni për një çati të re. Është e rëndësishme të theksohet që para se të përdoren, këto tjegulla duhen kontrolluar nëse kanë të çara. Kur ripërdorni tjegulla të vjetra, çdo tjegull duhet të kontrollohet për gjendjen e saj. Një metodë tradicionale e dobishme për këtë kontroll, është ta trokasësh tjegullën dhe të dëgjosh me kujdes zhurmën që ajo bën kur goditet. Kur zhurma është e fortë, tregon se tjegulla është e fortë dhe mund të përdoret përsëri.
- Megjithatë, mirëmbajtja dhe meremetimi i çative tradicionale shpesh mund



a. Foto e disa banesave të restauruara në Dhërmi. Çatitë janë rindërtuar me elemente në forma tradicionale.


b. Një konstruksion tipik i çatisë së një banese në Vuno. Struktura e çatisë është e vjetër, por e mirëmbajtur. Dhoma nuk ka tavan.

c. Prerje tërthore e një strukture tipike çatie të kësaj zone, ku përshkruhen të gjitha elementet e çatisë.


d. Prerje gjatësore e një çatie tipike, ku ilustrohen edhe hapësirat e mjedisit të banimit të katit të parë.



b.



c.



d.

3.7 Çatitë

të jenë të vështirë dhe të kushtueshëm. Për këtë arsye, është e rëndësishme të këshilloheni me një specialist profesionist.

- Mos i zëvendësoni tjegullat e vjetra, nëse ato ende kryejnë funksionin e tyre. Është me rëndësi që tjegullat e dëmtuara të zëvendësohen me të reja, që ruajnë formën, materialin dhe ngjyrat tradicionale të tjegullave origjinale.

Çatitë e reja

Sfida

- Banorët shpesh i zëvendësojnë çatitë me struktura, të cilat nuk ruajnë përpjesëtimet, formën dhe materialet tradicionale dhe që mund të dëmtojnë strukturën mbajtëse të banesës.
- Shtrimi i tjegullave ndonjëherë nuk bëhet siç duhet. P.sh., në bashkimin e tjegullave vihet re përdorimi i llaçit prej çimentoje ose i atij të ngjyrosur.
- Kornizat moderne nën strehët e çatave shpesh nuk janë tradicionale në formën, përmasat dhe materialet e përdorura.
- Banorët që kanë zëvendësuar çatitë e pjerrëta me soleta betoni (të cilat nuk janë tradicionale) shpesh hasin probleme me nxehtësinë apo të ftohtin si dhe me lagështinë dhe kërkojnë mirëmbajtje e vazhdueshme.
- Në çatitë e reja nuk bëhet diferencimi i llojit të tjegullave për kulme (tjegullat e vendosura në brinjët e çatave) nga ato për faqet (tjegullat e vendosura në faqet e çatisë) gjë që shpesh krijon probleme si estetike, edhe teknike.

Rekomandime

- Tjegullat e çatisë duhet të jenë të ngjashme me tjegullat tradicionale (artizanale) për sa i përket formës, qëndrueshmërisë së materialit dhe ngjyrës (ngjyrë argjile ose qerpiçi).
- Struktura e çatisë (p.sh. kapriata) duhet të bëhet prej druri të mirë të staxhionuar lisi, qiparisi ose bredhi, me lagështi prej 12-20%.
- Pjerrësia e çatisë duhet të jetë nga 20 deri 30° (mjeshtërit vendas i ndërtojnë zakonisht në pjerrësi 23 deri 28°).



a. Një çati dy-ujëse, karakteristike për këtë rajon. Tjegullat ndryshojnë lehtë në ngjyrë, për shkak të ekspozimit në diell dhe sepse janë të punuara në mënyrë artizanale.

b. Një soletë prej betoni, që është ndërtuar gjatë socializmit, duke zëvendësuar çatitë e vjetra tradicionale (në Palasë).

c. Një çati e re në Kudhës. Tjegullat e përdorura prej argjile janë tradicionale, por llaçi i përdorur për të bërë lidhjen e tjegullave është i ngjyrosur. Nuk është tipike për rajonin.





d.

d. Një pamje nga afër e detajit të një çatie në Qeparo. Trarët prej druri, pjesë e strukturës së çatisë, janë të dukshëm në fasadë.

e. Një strehë tipike çatie e një banese në Dhërmi. Janë përdorur dërrasa prej druri për të mbyllur hapësirën e strehës dhe pjesët e hapura janë suvatuar në mënyrë që uji, era apo insektet mos të futen brenda në banesë.

f. Një kornizë guri në pjesën e sipërme të murit të banesës. Korniza e gurit është një tjetër element tipik për këto zona, sidomos në banesën e Bregut. Këto elemente janë zakonisht të ndërtuar me gurë, por ndonjëherë përdoren dhe tulla.

- Në riparimin e çative me tjegulla të vendosura kapak dhe ulluk, tjegullat në rolin e ullukut mund të zëvendësohen lehtë pa ndikuar në pamjen e çatisë, duke qenë se janë shtresa më pak e dukshme.

- Nuk është i këshillueshëm ndërtimi i soletave të betonit në vend të çative të pjerrëta. Në rast se keni një soletë betoni dhe duhet ta prishni, sigurohuni që gjatë prishjes të mos ketë dëmtime të strukturës së mureve mbajtës. Në rastet kur prishja mund të ndikojë në mure, ju mund ta "maskoni" atë ose ta mbuloni soletën me një çati të stilit tradicional.

- Nuk duhen përdorur fletë metalike të valëzuara për mbulimin e çatisë.

- Nuk duhen përdorur elemente jo tradicionale, si baxhët, fashat metalike etj. Gjithashtu, format jo tradicionale si mansarda, çati shumë e pjerrët, çati me katër pjerrësi me anë jo të plota etj. nuk duhen përdorur.

- Nëse e gjykoni të arsyeshëm përdorimin e llaçit për lidhjen e tjegullave, përdorni llaçin e gëlqeres duke e vendosur me kujdes për të mos ndikuar në pamjen e çatisë.

Elementet e çatisë

Sfida

- Çatitë moderne kanë ulluqe horizontale dhe vertikale, por ato shpesh janë prej materialesh jo të përshtatshme, si p.sh. plastike me ngjyra të ndezura.

- Përdorimi i oxhakëve modern, të cilët kanë elemente metalike është problematik, duke qenë se nuk përshtaten me karakteristikat tradicionale.

- Depozitat e ujit mbi çati, përveçse dëmtojnë peizazhin tradicional të fshatit, krijojnë peshë të shtuar në çati dhe mund të krijojnë probleme strukturore.

- Panelet diellore të vendosura në çati gjithashtu janë shumë të dukshme dhe nuk përputhen me peizazhin karakteristik të fshatit.

Rekomandime

-Nuk duhen hequr oxhakët tradicionalë kur janë në gjendje të mirë. Oxhakët e rinj duhet të bëhen me tjegulla dhe të llaç. Duhen shmangur kapakët



e.




f.

3.7 Çatitë



a.





b.

a. Oxhak tipik i bërë me tjegulla argjile dhe llaç në një çati në Lukovë.

b. Një çati e sapo rindërtuar në Ilias. Në ndërtimin e kësaj çatie janë përdorur tjegulla jo tradicionale (në formë dhe ngjyrë) të cilat janë lidhur duke përdorur llaç. Oxhaku i ndërtuar me elemente metalike nuk është tradicional. Për këtë arsye, nuk rekomandohet përdorimi i tij.

c. Oxhak tipik i ndërtuar me 3-4 tjegulla argjile të vendosura vertikalisht dhe të lidhura me llaç për të krijuar një pus që tërheq tymin.

d. Pamje ballore dhe anësore e konstruksionit të oxhakut, i cili është ndërtuar me disa tjegulla të vendosura vertikalisht duke krijuar një trekëndësh, mbi të cilat është vendosur një shtresë horizontale, që shërben për të mbajtur strukturën dhe si mbulesë.



VINI RE!

- **NUK rekomandohet zëvendësimi i tjegullave të vjetra me tjegulla, të cilat nuk kanë të njëjtat karakteristika me to; çatia mund të rëndohet dhe të dëmtojë kështu strukturën e ndërtesës.**
- **NUK rekomandohet zëvendësimi i tjegullave të vjetra, nëse ato e kryejnë ende funksionin.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i ulluqeve horizontale dhe vertikale prej plastike.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i fletëve metalike të valëzuara si mbulesë çatie.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i elementëve jo tradicionalë në çati si p.sh. papafingo, baxhë ose hapje të llojeve të tjera.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i formave jo-tradicionale si tipologjia mansarde, çatia me shumë pjerrësi, çatia me katër pjerrësi me anë jo të plota etj.**
- **NUK rekomandohet heqja e oxhakëve ekzistues, kur janë në gjendje të mirë.**
- **NUK rekomandohet prishja e çative të vjetra. Kurdoherë që është e mundur, riparojini ato.**

e. Në shumë raste, në ndërtimin e çative, banorët përdorin një sasi të madhe binarësh dhe trarësh druri, të cilat nuk janë gjithnjë të nevojshëm dhe mund të rrisin peshën e çatisë deri në shembjen e saj. Fotoja tregon një çati të vjetër të një banese në Piqeras, që ka elemente të pakta druri dhe nuk ka shkaktuar probleme gjatë viteve. Tjegullat janë të dukshme nga pjesa e poshtme e çatisë dhe vihet re se nuk është përdorur llaç për lidhjen e tjegullave.

metalikë për çatitë. Oxhakët tradicionalë zakonisht nuk kanë pasur kapakë.
- Depozitat e ujit dhe panelet diellore të mos vendosen në vende të dukshme në çati, por nëse është e mundur në oborr. Duhet bërë fshehja e tyre në mënyrë që të mos dëmtojnë peizazhin tradicional të fshatit.

-Nuk rekomandohet vendosja e ulluqeve horizontale dhe vertikale në banesat që janë monument kulture.

-Në rast vendosjeje të ulluqeve horizontale dhe vertikale, ata duhet të jenë prej bakri ose alumini xingat. Është e rëndësishme që këto elemente të kenë ndikim sa më të pandjeshëm në fasadë.

-Materiale të tjera si p.sh ulluqet prej plumbi apo plastike nuk është mirë të përdoren. Ulluqet prej plumbi janë jo vetëm të shtrenjtë, por për më tepër, mund të ndotin ujin që kalon nëpër to.



e.



3.8 Hapësirat e brendshme



a. Detaj i tavanit të një banese në Lukovë, një element tipik i banesave tradicionale në këtë zonë. Tavani është prej druri dhe ka një rozetë me motive gjeometrike në qendër.

b. Foto e një oxhaku në odën kryesore të miqve në një banesë në Vuno.

c. Foto e zonës së një katoi në Qeparo. Hapësira është me qemer dhe muratura është e ashpër dhe e pa suvatuar. Në disa raste, muratura mund të lyhet me gëlqere si në foto, që vepron edhe si dezinfektues.

d. Një katua i kthyer në dhomë gjumi në një shtëpi pritëse në Qeparo. Ky është një shembull i mirë sesi hapësirat e banesave tradicionale mund të përshtaten për funksione të tjera. Foto e Herve Loiselet.

Dhomat

Hapësirat e brendshme të banesave në këtë rajon kanë zakonisht karakteristika të ngjashme. Në të kaluarën, banesat kanë pasur më shumë funksione sesa ka banesa e sotme. Diapazoni më i gjerë kushtëzohej nga një mënyrë e caktuar jetese, që i jepte banesës një ngarkesë funksionale relativisht të madhe. Larmia e funksioneve lidhej me gjendjen ekonomike dhe sociale të familjes: sa më e pasur të ishte familja, aq më shumë funksione kishte banesa. Shtëpia shërbente si banesë për familjen, si vend për mikpritjen e miqve dhe për festa e ngjarje të tjera. Kati përdhes përdorej si strehim për kafshët, si vend për grumbullimin e ushqimeve ku ndonjëherë aty vendosej edhe stera e ujit, ndërsa kati i parë për mjedise banimi. Në katua, vendoset edhe mulliri i vajit apo miellit. Në këto banesa kati përdhes përbëhet nga një hapësirë e vetme ku hyhet drejtpërsëdrejti nga jashtë. Ka edhe raste kur kjo hapësirë përbëhet nga dy kthina, ku hyrja kryesore e katit të çon në një paradhomë, prej së cilës kalohet në të dyja mjediset e dhomave.

Në banesat e kësaj zone hasim tipologjinë e odës së miqve, dhomës së zjarrit dhe katoit. Emri i secilës prej tyre lidhet drejtpërdrejt me funksionin. Dhoma e zjarrit është pak e ndriçuar dhe përmban zakonisht një oxhak. Në disa raste kjo njihet edhe si dhoma e bukës, ku edhe përgatitej buka. Në këtë dhomë shpesh ka edhe kamare në mure, të cilat përdoren si dollapë të vegjël për vendosjen e enëve apo sendeve të tjera. Oda e miqve, ashtu siç tregon emri, është dhoma ku priten miqtë. Oda e miqve si rregull, është më e mira për sa i përket kompozimit. Në të ndodhet oxhaku, në anë të të cilit vendosen dy kamare të vogla. Kjo është hapësira më e ornamentuar e banesës. Në disa raste, në odën e miqve ndërtohet dhe musandra. Veshja dhe objektet në këtë dhomë janë me dru. Tavani është gjithashtu prej druri dhe shpesh në qendër të tij është një rozetë me motive floreale ose gjeometrike. Oda shtrohej me qilima dhe velenxa, mbi të cilat uleshin sheshazi miqtë. Në rastet pak më të zhvilluara të banesave, përveç odës së miqve kishte edhe një apo më shumë oda të tjera, të cilat nuk kishin ndonjë dallim të madh nga



c.



d.



3.8 Hapësirat e brendshme

ajo e miqve. Në rastet kur banesa kishte shkallë të brendshme, ato kanë qenë ndërtuar me dru.

Pjesët e brendshme të murit

Në rastet kur muret nuk vishen me dru, siç ishin zakonisht në dhomën e miqve, pjesët e brendshme të mureve në katet e para të banimit suvatohen me llaç gëlqereje. Në katin përdhes, në hapësirat e katoit, muret zakonisht nuk suvatohen.

Muret e brendshme (muret e tipologjisë çatma)

Muret e brendshme të banesave janë shtuar në periudhat më të vona. Këto mure kanë zakonisht skelete prej dërrasash ose thuprash të lyera me baltë (qerpiç) ose me suva. Struktura e skeletit prej druri përbëhet nga elemente druri të fortë (zakonisht prej lisi) të vendosura për të krijuar një rrjetë mbajtëse dhe më pas të mbushur me thupra druri më të vogla (kryesisht prej druri më pak cilësor, si bredhi).

Kuzhinat dhe tualetet

Tradicionalisht, tualetet kanë qenë vendosur jashtë mjediseve të banesës. Vendet e gatimit ndodheshin në oborr, pranë ose ngjitur me banesën, ndërsa tualetet gjithmonë vendoseshin më larg. Që prej viteve '90-të, banorët i kanë vendosur këto mjedise brenda banesës ose kanë ndërtuar struktura të veçanta bashkëngjitur shtëpisë.

Ndërtimet e Reja dhe Rinovimet

Sfida

- Shpeshherë vihet re mungesë njohurish për materialet dhe teknikat e duhura për rinovimin dhe mbrojtjen e tyre apo për teknikat më bashkëkohore për elementet e ndërtesave historike.
- Elementet origjinale të ndërtesave si p.sh oxhaku, sergjenët, kamaret etj.



a. Mur i brendshëm tipik me çatma. Pamja nga afër tregon skeletin prej degëve të drurit dhe suvatimin me llaç gëlqereje.

b. Një konstruksion i ri i çatisë së një banese në Himarë. Trarët kryesorë janë të ripërdorur nga një tjetër banesë në këtë zonë, ndërsa elementet e tjerë janë prej druri të staxhionuar, gjetur në tregjet përreth.

c. Mobilim tradicional i një ode miqsh të një banese në Dhërm. Meqenëse banesa është monument kulture i kategorisë I, dekorimet dhe elementet e hapësirave të brendshme janë të ruajtura në gjendje shumë të mirë, gjë që është e vështirë të gjendet diku tjetër.





d. Shkallë të brendshme tipike prej druri, të cilat të çojnë në katin e parë të banesës. Në foto, shkallët e një banese në Ilias, që janë mirëmbajtur si duhet gjatë viteve.

e. Një oxhak tipik i një banese në Lukovë. I vendosur kryesisht në odën e miqve, oxhaku është një nga elementet kryesore në hapësirat e brendshme të banesave tradicionale.

f. Mur guri i një dhome ndenjeje të një banese në Vuno. Është përdorur teknikë e përshtatshme e vendosjes së llaçit lidhës (fugave) dhe janë ruajtur kamaret e murit në anët e oxhakut, të cilat ruajnë po të njëjtin funksion të ekspozimit të sendeve shtëpiake.

g. Foto të kamareve me kapakë druri, tipike të kësaj zone.

shpesh prishen dhe zëvendësohen me struktura të reja, të cilat nuk ruajnë karakteristikat e atyre origjinale. Në shumë raste, ndryshohet edhe pozicioni i oxhakut në banesë.

- Tavanet e odës, të cilat janë veçori tepër me rëndësi të këtyre banesave po shkatërrohen dhe humbin për shkak të mungesës së mirëmbajtjes.

- Banesave iu bëhen transformime duke përdorur materiale të papërshtatshme si p.sh struktura të rënda betoni për të hapur vend për kuzhinat dhe tualetet brenda banesës; ose hapësirat e brendshme ndryshohen, duke mos respektuar kompozicionin e brendshëm, hyrjen, vendndodhjen, pamjen apo karakterin e ndërtesës etj.

- Futja e tubacioneve të nevojshme, kablllove dhe pajisjeve për kuzhinat dhe tualetet e brendshme brenda strukturës së ndërtesës, mund të ndikojë në kapacitetin mbajtës të ndërtesës.

Rekomandime

- Ruani dhe mirëmbani oxhakët ekzistues, veçanërisht në odën e miqve. Të mos ndërtohen oxhakë të rinj në rast se ata ekzistues janë në gjendje të mirë dhe të mos ndryshohet pozicioni i oxhakut apo mënyra e ndërtimit të tij (mos përdorni veshje me mermer apo tulla).

- Ruajini kamaret e mureve. Mos i mbuloni ato.

- Shtrimi i dyshemesë së dhomave të banimit duhet bërë me dru (ashtu siç kanë qenë dikur), sepse ashtu si edhe muratura prej guri, dyshemetë e drurit janë elemente tradicionale të banesave historike (dyshemetë prej betoni mund të shkaktojnë probleme për shkak të peshës së tyre të shtuar, lëvizjeve termike, izolimit etj.).

- Nëse është nevojshme, për shtrimin e dyshemeve të hapësirave që nuk janë për banim (p.sh., qilari), të cilat asnjëherë nuk kanë pasur dysheme druri, mund të përdorni edhe çimento apo rrëshirë artificiale, në vend të drurit. Megjithatë, duhet patjetër të këshilloheni me një specialist, sepse këto materiale mund të dëmtojnë muraturën e gurit.





3.8 Hapësirat e brendshme

- Muret e brendshme duhen ndërtuar me struktura të lehta. Mund të përdorni tipologji çatmaje ose tulla të lehta (një shtresë tullash).
- Shkallët ekzistuese prej druri duhet të mirëmbahen dhe nëse është e nevojshme të ndërtohen shkallë të reja këshillohet zëvendësimi me struktura të ngjashme të lehta (kryesisht dru, por mund të përdoret edhe metali).

Materialet

Sfida

- Materialet e hershme tradicionale (veçanërisht ato në hapësirat e brendshme) kërkojnë kujdes të vazhdueshëm për t'i mirëmbajtur e pastruar.
- Shpesh është e vështirë për të gjetur në treg dru të cilësisë të mirë.

Rekomandime

- Është e rëndësishme që banorët të kujdesen vazhdimisht për elementet e brendshme të banesës, sidomos për ato prej druri.
- Vajosja e drurit është një teknikë e vjetër e përdorur për mbrojtjen e tij si në mjediset e brendshme ashtu dhe ato të jashtme. Ndodh që vaji i linit shpesh depërton vetëm 5 mm në sipërfaqen e drurit, duke e lënë pjesën tjetër të patrajtuar. Në ditët e sotme ka një shumëllojshmëri më të madhe trajtuesish natyralë për drurin, të cilët mund ta mbrojnë edhe më mirë atë. Këta gjenden kudo në njësitë e shitjes së materialeve të ndërtimit, por është e rëndësishme të këshilloheni me specialistë për këtë çështje.

Të tjera

Sfida

- Ngrohja e banesës gjatë muajve të dimrit mund të jetë problematike, sidomos për banorët që jetojnë gjatë gjithë vitit në fshat.
- Një sistem i përdorshëm rëndom sot në këto fshatra, për ftohjen e banesës, janë kondicionerët. Por, shpesh ata janë të pamjaftueshëm për të zgjidhur plotësisht problemin e temperaturave të larta gjatë muajve të verës.



a. Një dhomë e katit të parë të një shtëpie pritëse në Piqeras. Për ndarjen e dhomave janë përdorur elemente dërrase: një mënyrë e mirë e ndërtimit të mureve të brendshme sepse nuk krijojnë peshe të shtuar në strukturë. Ky element përshtatet me arkitekturën tradicionale të banesës.

b. Hapësirat e brendshme të një shtëpie pritëse në Qeparo. Banesës i është shtuar një kat ndërmjetës me strukturë druri i ndërlidhur me një shkallë metalike. Foto e Herve Loiselet.

c. Një konstruksion i lehtë muri të brendshëm (teknikë çatma) i një banese në Vuno, ndërtuar me elementë druri të bashkuar me llaç. Më parë, muri ka qenë i suvatuar, por për shkak të dëmtimit është hequr, duke i lënë elementet e drurit të ekspozuara. Në mënyrë që të parandalohet plasaritja e suvasë, preferohet përdorimi i gëlqeres së staxhionuar, pasi ka aftësi më të mira lidhëse dhe qëndron mirë në sipërfaqen ku aplikohet.



VINI RE!

- **NUK rekomandohet heqja e veshjeve të drurit ose mureve të brendshme të çatmasë, përveç rasteve absolutisht të nevojshme (për shkak të mykut, dëmtimit, thatësisë etj.). Nëse rinovimi është patjetër i nevojshëm, këshillohet të përdoren materiale dhe teknika origjinale ose që përshtaten me origjinalet.**
- **NUK rekomandohet heqja e oxhakëve origjinalë ose ndryshimi i pozicionit të tyre në dhomë. Gjithashtu, nuk këshillohet transformimi i oxhakëve origjinalë ose ndërtimi i oxhakëve të rinj, duke përdorur materiale të papërshtatshme për veshje si mermeri, pllaka guri, tulla etj.**
- **NUK rekomandohet mbulimi i kamareve të murit.**
- **NUK rekomandohet përdorimi i mureve prej betoni për të krijuar hapësira të reja të brendshme.**

d. Shtrim tipik dyshemeje i një banese në Himarë. Për shtrimin e dyshemesë është përdorur dru pishe i përpunuar dhe i staxhionuar. Ndryshimi në nivele, që dallohet në foto, ka ndodhur për shkak të futjes së sistemit të ngrohjes nën dysheme.


e. Tradicionalisht, për shtrimin e dyshemeve të banesave tradicionale janë përdorur tapete dhe qilima. Këto elemente, zakonisht të bërë prej leshi, përveçse janë të domosdoshme gjatë muajve të dimrit me temperatura të ulëta, veprojnë gjithashtu edhe si izolues akustikë dhe zvogëlojnë zhurmën që vjen nga dyshemetë e drurit. Për më tepër, këto elemente janë të rëndësishme në parandalimin e dëmeve fizike tek elementët e drurit, duke rritur kështu jetëgjatësinë e dyshemeve prej druri.

f. Kjo foto tregon një shembull të mirë të përdorimit të drurit si element ndarës kati. Konstruksionet e drurit janë të lehta, nuk i shtojnë peshë të tepërt strukturës së banesës dhe përshtaten me strukturën e muraturës së gurit, siç paraqitet në këtë shembull të një banese në Himarë fshat.

Rekomandime

- Metoda tradicionale për të freskuar banesën gjatë muajve të verës ka qenë ajo e ventilimit natyral, që kryhej nga dritaret e pozicionuara nga veriu. Por, në ditët e sotme shumë prej këtyre dritareve janë mbyllur prej vitesh dhe nuk janë më funksionale. Nëse ka gjurmë që këto dritare kanë ekzistuar, rekomandohet që ato të rihapen. Ventilimi i kryqëzuar që sigurohet nga hapja e dritareve të banesës, edhe pse ndoshta jo më optimali gjatë dimrit, sjell freskim gjatë verës, si edhe ul kostot e kondicionerëve apo freskuesve elektrikë.

- Nëse është e realizueshme dhe e përballueshme, duhet të instalohet ngrohja qendrore në mënyrë që të gjitha shtëpitë të mund të përdoren edhe gjatë muajve të dimrit. - Ndërlidhjet e brendshme për tubacione, për tualetet, lidhjet furnizuese, tubacionet e shkarkimit etj. duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të krijojnë mundësinë për riparime të nevojshme. Kurdoherë ato duhen vendosur në mënyrë jo të dukshme, të fshehura pas paneleve.



Fjalor shpjegues termash

Gurë që lihen pak më të dalë nga muri i banesave tradicionale, të cilët janë ndërtuar për zbukurim apo mbrojtje. Këto elemente mund të shërbejnë gjithashtu edhe për të varur diçka a për të vënë vazo lulesh mbi to.

Tipologji banese tradicionale shqiptare, ku kati përdhes shërben për mbajtjen e bagëtive, ndërsa kati i parë është i banuar.

Banesë tipike tradicionale shqiptare, e ngjashme me banesën me kat, nëntipologji e saj, por në këtë rast, kati i parë gjendet pjesërisht mbi katin përdhes e pjesërisht përdhe, për shkak se kati përdhes mbështetet në terren.

Banesë karakteristike e fshatrave të Bregut, e zhvilluar në mesin e shekullit XIX, e cila nuk e ka më funksionin e mbajtjes së bagëtive në katin përdhes, duke e kthyer edhe atë në kat të banuar. Kjo banesë ka kompozicion simetrik.

Termi vendas për kapakët prej druri të dritareve.

Binar i gjatë druri, i cili vihet përgjatë murit që ndërtohet me gurë, për ta lidhur ose për ta forcuar.

Çati tradicionale me dy pjerrësi.

Çati tradicionale me katër pjerrësi.

Mure të holla, të ndërtuara me skelet druri dhe veshje prej rripash dërrase apo shufra kallamash. Rripat e dërrasës quhen paretka dhe vendosen në të dy anët e disa shtyllave druri që përdoren si strukturë mbajtëse e çatmasë. Kështu lihet një hapësirë bosh midis dy paretkave që mbushet me lidhës – dy duar llaç – llaç gëlqereje me lesh dhie apo kashtë dhe një shtresë me llaç gëlqereje.

Lloj menteshe metalike tradicionale, që shërben për të mbërthyer e për të mbajtur nga njëra anë kanatet e dyerve a të dritareve, në mënyrë që të hapen e të mbyllen lirisht.

Punimi i muraturës së gurit pa llaç lidhës. Teknikë e vjetër dhe e përdorur kryesisht për muret rrethuese.

Një e çarë e vogël dhe e ngushtë si dritare, në muret e kullave ose të kështjellave, që shërbente për të qëlluar me armë.

Pjesa ndërmjet gurëve e mbushur me llaç që i lidh ata.

Teknikë tradicionale e vendosjes së suvasë, sipas të cilës sipërfaqja e gurëve mbulohet pjesërisht, jo më shumë se një gisht.

Secili prej trarëve të hollë, që zbresin në trajtë gërrshëre nga kulmi i çatisë në strehë, mbi të cilët mbërthehen petavrat.

Llaç i përbërë prej pluhur tulle të përzier me gëlqere të shuar.

Hapësirë e vogël në mur, që shërben për vendosjen e sendeve të ndryshme shtëpiake.

Me këtë emërtim thirren katër lloj ndërtimesh: 1. kullat e veçuara; 2. kullat përbri banesave për mbrojtje pasive; 3. konstruksionet me kolonë-hark e qemer që krijojnë një lloj tarrace përbri çardakut; 4. tarracat mbi portat e hyrjes.

Anëcark

Banesë me Kat

Banesë me Gjysmë Kat

Banasa e Bregut

Baxhukë

Brez

Çati dy-ujëse

Çati katër-ujëse

Çatma

Çernierë

Ndërtim në të thatë

Frëngji

Fuga

Fugatim

Gërrshërëz

Horasan

Kamare

Kamerie

Katua	Hapësirë në katin përdhes të një shtëpie, ku mbahen kafshët shtëpiake dhe prodhimet bujqësore; bodrum, qilar.
Krua	Burim uji, zakonisht i rregulluar me një lug a lëfyt dhe në disa raste i zbukuruar me ornamente.
Kulmore	Tjegullat e vendosura mbi trarët kulmorë të çatisë.
Kthinë	Pjesë e ndarë në një shtëpi; odë, dhomë.
Madëm	Term vendas për guroret.
Mahi	Secila nga gërshtëzatat anësore të çatisë së një ndërtese, që shkojnë nga kulmi në strehë.
Oda	Dhomë kryesore në banesën tradicionale, ku priten miqtë.
Petavër	Dërrasë e hollë, e gjatë dhe e ngushtë që përdoret zakonisht për të mbuluar çatinë e shtëpisë. Ato kapen mbi gërshtëzatat dhe mbi to rradhitën tjegullat.
Qemer	Hark prej guri që bëhet sipër dymve dhe dritareve në banesat tradicionale.
Qerpiç	Tullë prej balte e tharë në diell dhe jo e pjekur në furrë.
Rozetë	Një element në qendër të tavanit, i punuar me kujdes dhe i zbukuruar.
Sergjen	Brez i gjerë dërrase në formë konsoli i vendosur në lartësinë e trupit të njeriut rreth e rrotull mureve të dhomës. Shërben për vendosjen e enëve apo sendeve të tjera shtëpiake.
Sofat	Vend për t'u ulur në të dy anët e portës së shtëpisë, zakonisht i krijuar me gurë të mëdhenj të vendosur rrëzë murit.
Sterë	Depozitë për grumbullimin e ujërave të shiut.
Tiranta	Elemente metalikë, që shërbejnë për të mbajtur të lidhur gurët në restaurimin e banesave tradicionale me gurë.

Shkurtime

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AZHR	Agjencia për Zhvillim Rajonal
CHwB	Trashëgimia Kulturore pa Kufij
DRKK	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GIZ	Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
Programi ISDSCR	Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës

Bibliografia

A. Meksi, A. Baçe, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, *Historia e arkitekturës në Shqipëri*, Kristalina KH, Tiranë 2016.

Design Guidelines for the City of Lviv– Advice and rules for the preservation of historical buildings, Lviv City Council and GIZ 2011 (Ukrainë); Find the document in German and in Ukrainian under: <http://www.urban-project.lviv.ua/en/index>

E. Riza, *Banesa popullore në fshatrat e rrethit të Vlorës*, në Monumentet 15-16, Tiranë 1978, f. 185-220.

E. Riza, *Arkitektura e banesës popullore në zonën e “bregut të detit” (Labëri)*, në Monumentet 19, Tiranë 1980, f. 3-27.

E. Riza, *Ndërtimet Fshatare në Labëri*, 8 Nëntori, Tiranë 1984.

E. Riza, *Orendimi dhe pajisjet arkitektonike në banesën popullore qytetare*, në Etnografia shqiptare 15, Tiranë 1987, f. 165-178.

E. Riza, P. Thomo, *Albanie*, në *Architecture traditionnelle des Pays Balkaniques* (Atene), Albanie, 1990, f. 19-82.

E. Riza, *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX*, Dita 2000, Tiranë 2009.

E. Bakalova, E. Buculei, O. Etinhof, R. C. Campanati, M. Garidis, A. Stojakovic, P. Thomo, *Multilingual Illustrated Dictionary of Byzantine Architecture and Sculpture Terminology*, Crete University Press, Herakleion 2010.

E. Tsakanika, *Byzantine and Post – Byzantine Historical Timber Roofs in Greece. Typical Failures, Misunderstanding of their Structural Behaviour, Restoration Proposals*, në ICOMOS IWC - XVI International Symposium, Florence & Venice, 2007.

F. Pashako , A. B. Menghini, *Architettura Domestica Tradizionale Albanese XVI –XIX Secolo. Riconoscimento dei Principi Insediativi e Costruttivi della Casa di Berat. Per un codice Compositivo Contemporaneo*.

Politenico di Bari– Dipartimento di Scienze dell’Ingegneria civile e dell’Architettura (ICAR), Dottorato di Ricerca in Progettazione Architettonica per i Paesi del Mediterraneo- XXV ciclo, January 2010 – December 2012.

I. Papanikolla, P. Nishani, Gj. Çaçani, S. Çoçoli, M. Kabili, *Elemente të ndërtesës dhe teknologjia e tyre*, Shtrypshkronja e Re, Tiranë 1990.

I. Papanikolla, *Konstruksione arkitektonike 1*, UFO Press, Tiranë 2008.

M. Mitrojorgji, *Duke lexuar hapësirën, sintaksa e elementeve arkitektonike*, UFO Press, Tiranë 2008.

V. Shtylla, *Ujësjiellës dhe çezma në vendin tonë*, në: Tradita ndërtimore në Shqipëri, Instituti i Monumenteve të Kulturës, 8 Nëntori, Tiranë 1981, f. 36-43.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM):

http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&id=155:national-park-of-llogara&Itemid=435&lang=us, parë së fundmi në maj 2018.

Albanian Photography: <http://www.elsie.de/index.htm>, parë së fundmi në maj 2018.

Herve Loiselet Interior Design: <http://hlinterior.com/>, parë së fundmi në maj 2018.

Fjalor online i gjuhës shqipe "Fjalë:" <https://fjale.al>, parë së fundmi në qershor 2018.



Mirënjohje dhe falënderime të veçanta të gjithë personave të mëposhtëm për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre, gjatë procesit të përgatitjes së këtij udhëzuesi:

Rineldi Xhelilaj, DRKK Vlorë, për gatishmërinë e vazhdueshme për konsultime, mbështetjen me ide dhe dije, dëshirën e mirë për ta ndarë me ne çdo informacion të dobishëm.

Ekipi i ISDSCR:

Hans-Jürgen Cassens
Valbona Koçi
Dhurata Gazulli
Aurora Xheka
Eneida Berisha

Arta Dollani, Drejtore IMK
Marsela Plyku, IMK
Joli Mitrojorgji, IMK
Mirela Jano, IMK
Arben Spaho, IMK
Orgest Feimi, DRKK Vlorë
Gentian Stratobërdha, Bashkia Himarë

Maryana Kukhlevska
Annemarie Rothe

Adelina Greca, AKPT; Alba Canaj, MIE; Alma Balliu; Andi Prifti, AZHR4; Andi Ahmati; Arlind Dervishaj, MIE; Boralda Bendaj; Dorian Tytymçe; Efijeni Kokëdhima; Egda Rapo; Elena Mamani, CHWB; Elis Halili; Eltjana Shkreli, GO2; Elvi Kola; Endrit Fifa; Eni Ajdini; Eugen Zizaj; Fatjon Saliu; Ferdinand Dhrami, MoH; Fjona Zanalui; Florian Nepravishta, FAU; Genci Samimi; Gentian Stratobërdha, BH; Gilserena Mirashi; Herve Loiselet; Irola Andoni, AKPT; Ilva Gjuzi, MIE; Jorgo Goro, BH; Jonida Gjoka; Jutta Benzenberg; Klodiana Demaj; Kreshnik Merxhani; Laura Ferati; Pirro Thomo; Pirro Vaso; Shpresa Smajli; Silvia Azizaj; Vilma Picari; Valjano Cama,*

Kryetarët e fshatrave: Aleks Marko, Dhërmi; Artan Bala, Vuno; Azem Gjoca, Borsh; Ridvan Hajdini, Borsh; Gorgo Gjomeno, Ilias; Odhiese Dhimolea, Palasë; Kiço Vlashi, Shën Vasil; Niko Jovani, Kudhës; Niiqiforo Butsi; Lukovë; Stefan Kokëdhima, Qeparo.

*Personat e pranishëm në forumet e organizuara në Tiranë dhe Dhërmi, në kuadrin e hartimit të udhëzuesit.

Shprehim falënderime të veçanta për banorët e fshatrave, të cilët na mikpritën me bujarë dhe shpenzuan kohën e tyre për të na dhënë informacione shumë të vlefshme:

Aleko, Vasil Guma, Janaqi, Sokrati, Zotëria nga Kuçi, Pandeliu, Nëna Fillo, Nëna Vasiliqia, Lefteri Dhrami; Thodhori Kashta, Pirro Konomi, Thanas Çaçi, Pilo Çobani; Kristofor Gjomeno, Mësuesi nga Tirana, Zoti Lluca; Jorgo Bitri, Dy nënat, Familja e Bejazes, Irini Memi; Qiriako Prifti, Petri Konomi, Elefteri Mërtiri; Zotëria nga Kudhësi; Luljeta Çipa, Ndreko Lapa; Pranvera Andoni, Nëna Andoni, Thoma Koça, Tomi, Nëna Vasiliqia, Arjan Konomi, Stefan Andoni, Nëna Elvira; Spiro Leka, Theodhori Leka, Vasiliqi Zhupa, Nëna Dafina, Andon Marko, Aleks Marko; Egda Rrapo, Sokrati, Vasili, Andrea Bitri, Zotëria nga Piluri; Zonja Zana, Dhimo Gjoni.



Koordinatorë

Programi i Zhvillimit të Integruar dhe të Qëndrueshëm të Rajonit Bregdetar Jugor, GIZ Shqipëri
Hans-Jürgen Cassens / Drejtori i Përgjithshëm i GIZ Shqipëri;
Valbona Koçi, Dhurata Gazulli/ Koordinatorë të Programit ISDSCR

Koordinatore për Udhëzuesin praktik për mbrojtjen dhe ruajtjen e banesave tradicionale të
fshatrave të bregdetit të Himarës: Valbona Koçi
Eksperte: Iris Gleichmann, Frida Pashako

Autore

Frida Pashako
Iris Gleichmann
Erisa Nesimi (asistente e eksperteve)
Jona Osmani (asistente e eksperteve)

Editimi

Ben Kern (EN)
Iris Gleichmann (EN)
Saemira Pino (AL)
Erisa Nesimi & Eneida Berisha (Përkthim)

Faqosja

Erisa Nesimi
Jona Osmani

Materialet grafike

Jona Osmani
Erisa Nesimi
Mirjana Pali
Arjon Kadillari
Eneida Berisha
Burimi: Arkiva e Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe literatura përkatëse

Fotografia

Armand Habazaj
Erisa Nesimi
Jona Osmani
Joerg Daiber (Spoonfilm Medienproduktion GmbH)

Botuar nga

Gent Grafik, në Korrik 2018
Rr. "Ismet Gusia", Nd. 33, H.1,
Njësia administrative Nr. 1, 1004, Tiranë

GIZ është përgjegjës për përmbajtjen e këtij botimi
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara

Bonn dhe Eschborn, Gjermani
Programi i Zhvillimit të Integruar dhe të Qëndrueshëm të Rajonit Bregdetar Jugor
Rr. Skënderbej 21/1, Tirana, Albania
Tel. +355 42 230 414
<https://www.giz.de/en/worldwide/39273.html>

Në emër të:
Ministritë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ)

Në bashkëpunim me:
Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
Ministrinë e Kulturës (MK)
Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK)
Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë (DRKK)
Bashkinë Himarë

© Copyright me GIZ, Korrik 2018



Implemented by





Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH